

DOKUMENT REKOMANDIMESH

**SHQYRTIMI ANALITIK I INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE:
RREGULLORJA E BE-SË PËR SHQYRTIMIN E IHD-VE DHE
PERSPEKTIVA E SHQIPËRISË NË KUADËR TË
ANËTARËSIMIT NË BE**





**DOKUMENT REKOMANDIMESH: Shqyrtimi i Investimeve të Huaja
Direkte: Rregullorja e BE-së për Shqyrtimin e IHD-ve dhe
Perspektivat e Shqipërisë në Kuadër të Anëtarësimit në BE
Dhjetor 2023**

Ky studim është mbështetur nga një Grant i Qendrës për Sipërmarrjet Private Ndërkombëtare në Washington D.C., përmes projektit Nxitja e Dialogut Publik-Privat për Sigurinë e Investimeve, të zbatuar nga ICC Albania. Përmbajtja e këtij studimi politikash përfaqëson mendimet dhe analizën e autorëve dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht mendimet e ICC Albania dhe CIPE apo të punonjësve të tyre. Informacioni i dhënë në këtë botim paraqitet “siç është”; dhe askund nuk konfirmohet që përmbajtja nuk ka gabime.

SHKURTIME DHE SHKURTESA	6
LISTA E GRAFIKËVE, TABELAVE, KUTIVE DHE SHTOJCAVE	7
I. Kuadri i përgjithshëm	8
II. ÇFARË JANË MEKANIZMAT PËR SHQYRTIMIN E IHD-VE	9
2.1 Historia e mekanizmave për shqyrtimin e investimeve.....	9
III. SHQYRTIMI I INVESTIMEVE NË BE	12
3.1. Kuadri historik dhe konteksti	12
3.1.1. Nevoja për trajtimin e rrezikut gjeo-ekonomik.....	12
3.1.2. Zhvendosja e fokusit të legjislacionit për investimet.....	13
3.2. Shpjegim i shkurtër i Rregullores 2019/452	15
3.2.1. Premisat dhe arsyetimi ligjor	15
3.2.2. Përkufizimi i mekanizmit të shqyrtimit.....	15
3.2.3. Përkufizimi i sigurisë dhe rendit publik	16
3.2.4. Faktorët që bëhen shkas për shqyrtimin dhe ndërveprimi i rregullores me ligjet kombëtare	16
3.2.5. Mospasja e një pragu minimal	16
3.2.6. Krijimi i një mekanizmi bashkëpunimi dhe rritja e transparencës brenda BE-së	17
3.2.7. Vendimi përfundimtar pas procesit të shqyrtimit	17
3.2.8. Kompetencat e Komisionit për shqyrtimin e drejtpërdrejtë	18
3.2.9. Rishikimet e mëtejshme.....	18
3.3. Mekanizmat e shqyrtimit të Shteteve Anëtare: të dhëna dhe zhvillime	18
3.4. Shembuj të kërkesave për shqyrtimin e IHD-ve	21
3.5. Çfarë të presim më pas?.....	22
3.6. Regjimet e shqyrtimit të IHD-ve dhe vendet e Ballkanit Perëndimor.....	23
IV. IHD-TË NË SHQIPËRI	25
4.1. IHD-të si kontribuuese në ekonominë shqiptare: fluksi, stoku dhe origjina	25
4.1.1. Fluksi i IHD-ve.....	25
4.1.2. Stoku i IHD-ve	28
4.1.3. Vendi i origjinës së IHD-ve	29
4.2. Kuadri ligjor dhe rregullator.....	31
4.2.1. Nga një ekonomi e centralizuar në një regjim të hapur.....	31
4.2.2. Kuadri institucional dhe qeverisja.....	34
4.3. Mekanizmat për shqyrtimin e investimeve në Shqipëri.....	35
4.3.1. A ka gjurmë të shqyrtimit të IHD-ve?.....	35
4.3.2. A ka ndonjë kufizim sektorial?	36

4.3.3.	Miratimi i një ligji të unifikuar për investimet	38
4.4.1.	Treguesit e cilësisë së IHD-ve	40
4.4.2.	Udhëzimet e OECD-së për NHH-të.....	41
4.4.3.	Kuadri i kapitalit gërryes dhe kapitalit të strukturuar.....	42
V.	PËRFUNDIME.....	47
VI.	REKOMANDIME	48
6.1.	Zgjidhje të zgjuara për MSHI-të.....	48
6.2.	Drejt një legjislacioni të unifikuar dhe bashkëkohor për IHD-të	50
SHTOJCA 1.....		51
Mekanizmat e shqyrtimit të IHD-ve në disa juridiksione		51
SHTOJCA 2		52
Modeli gjerman		52
BIBLIOGRAFIA		54

DOKUMENT REKOMANDIMESH: Shqyrtimi i Investimeve të Huaja Direkte: Rregullorja e BE-së për Shqyrtimin e IHD-ve dhe Perspektivat e Shqipërisë në Kuadër të Anëtarësimit në BE

Dhjetor 2023

Ky studim është mbështetur nga një Grant i Qendrës për Sipërmarrjet Private Ndërkombëtare në Washington D.C., përmes projektit Nxitja e Dialogut Publik-Privat për Sigurinë e Investimeve, të zbatuar nga ICC Albania. Përmbajtja e këtij studimi politikash përfaqëson mendimet dhe analizën e autorëve dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht mendimet e ICC Albania dhe CIPE apo të punonjësve të tyre. Informacioni i dhënë në këtë botim paraqitet “siç është”; dhe askund nuk konfirmohet që përmbajtja nuk ka gabime.

Përgatitur nga:

Elvis Zerva, Avokat, Ndihmës Raportues për Vendin, Instituti CELIS
Gladiola Ago, Avokat i Nivelit të Lartë, Boga & Associates
Joani Leka, Avokat i Nivelit të Lartë, Deloitte Legal
Viktoria Spiro, Avokat, Boga & Associates

Rreth ICC Shqipëri

Që prej vitit 2012, ICC Albania është Komisioni Kombëtar i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) në Shqipëri. ICC Albania është zëri përfaqësues i ICC-së në Shqipëri dhe ofron mekanizma me qëllim që sektori privat të angazhohet në mënyrë të efektshme në formulimin e politikave, standardeve dhe rregullave ndërkombëtare.

Përmes një kombinimi unik të advokimit, zgjidhjeve dhe përcaktimit të standardeve, ne promovojmë tregtinë ndërkombëtare, sjellje të përgjegjshme të biznesit dhe qasje botërore ndaj legjislacionit, përveç ofrimit të shërbimeve elitare në treg për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Vizitoni icc-albania.org.al, LinkedIn, Facebook, Instagram ose platformën X për më shumë informacion rreth ICC Albania

Rreth CIPE

“Qendra për Sipërmarrjen Private Ndërkombëtare (CIPE) është organizatë globale që punon për forcimin e demokracisë dhe zhvillimin e tregjeve konkurruese në shumë prej mjediseve më sfiduese në botë. Përmes punës përkrah partnerëve vendorë dhe udhëheqësve të së nesërme, CIPE çon përpara zërin e biznesit në politikëbërje, promovon mundësitë dhe zhvillon ekonomi rezistente dhe gjithëpërfshirëse. Themeluar në vitin 1983 në Washington D.C., CIPE është aktualisht aktive në më shumë se 80 vende dhe ka një rrjet të madh botëror me partnerë nga sektori privat dhe shoqëria civile. CIPE është institut themelor i “Ndihmës Kombëtare për Demokraci” dhe një degë jofitimprurëse e Dhomës së Tregtisë të SHBA-së. **Vizitoni cipe.org, LinkedIn, Facebook, ose Twitter për më shumë informacion rreth CIPE.**

Shtypur në dhjetor 2023

Të drejtat e autorit të rezervuara © 2023

Të gjitha të drejtat e rezervuara. ICC Albania dhe CIPE zotërojnë të gjitha të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të pronësisë intelektuale. Asnjë pjesë e këtij punimi nuk mund të riprodhohet, kopjohet, shpërndahet, transmetohet, përkthehet, apo përshtatet në asnjë formë dhe me asnjë mjet grafik, elektronik, apo mekanik, përfshirë dhe pa u kufizuar në fotokopje, skanim, regjistrim, hedhje në shirit, ose përdorim me kompjuter, përmes internetit apo sistemeve të gjetjes së informacionit, pa lejen me shkrim të ICC Albania dhe CIPE.

Rreth Autorëve

Elvis Zerva LL.M, EMBA

Z. Zerva është profesionist me përvojë në biznes, në të drejtën e investimeve dhe në studimet e dialogut të politikave. Ai është anëtar i Dhomës Kombëtare të Avokatisë që prej vitit 2021, Ndhmës Raportues për Vendin pranë Institutit CELIS, Berlin, forumi drejtues i studimit të politikave të shqyrtimit të investimeve. Z. Zerva punon prej tetë vitesh si konsulent i BERZH-it në pozicionin e Ekspertit Ligjor dhe Rregullator në Sekretariatit e Këshillit të Investimeve të Shqipërisë. Z. Zerva është i diplomuar për drejtësi në nivelin Bachelor, ka një LL.M nga Universiteti i Tiranës dhe një EMBA nga Quantic School of Business and Technology, Washington, D.C. Ai ka ndjekur kurse ekzekutive të edukimit në Yale School of Management dhe London School of Economics dhe ka një sërë kualifikimesh nga institucione kombëtare dhe ndërkombëtare.

Gladiola Ago

Gladiola Ago është Avokate e Nivelit të Lartë pranë Boga & Associates Ajo ndihmon klientët lidhur me aspekte të së drejtës së korporatave, përfshirë çështjet e të drejtës tregtare, punësimit, konkurrencës dhe pronësisë intelektuale. Zj. Ago këshillon shoqëritë për çështjet e qeverisjes së korporatës, përfshirë përmbushjen dhe aspektet rregullatore. Ajo ka diplomë bachelor në drejtësi si dhe diplomë master për të drejtën private të fituara në Universitetin e Tiranës.

Joani Leka

Joani Leka është Avokat i Nivelit të Lartë pranë Deloitte Legal në Shqipëri. Gjatë përvojës së tij me Deloitte Legal, Joani ka dhënë kontribut në disa angazhime madhore, duke këshilluar korporata ndërkombëtare dhe vendase në tregun shqiptar lidhur me të drejtën e korporatave, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe legjislacionin tatimor. Puna e tij përqendrohet në industri si energjia dhe burimet, shërbimet financiare dhe ndërtimi. Joani është diplomuar në Universitetin e Tiranës dhe është anëtar i Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

Viktoria Spiro

Viktoria Spiro është Avokate në Boga & Associates. Ajo ndihmon shoqëritë vendase dhe të huaja në çështje që lidhen me të drejtën e biznesit, si dhe legjislacionin, përmbushjen dhe konkurrencën në fushat e energjisë dhe bankave. Ajo është pjesë e ekipit që këshillon klientët lidhur me një sërë transaksionesh të ndërlikuara tregtare. Zj. Spiro ka diplomë bachelor në drejtësi si dhe diplomë master për të drejtën publike të fituara në Universitetin e Tiranës. Ajo është anëtare e Dhomës Kombëtare të Avokatisë që prej vitit 2018.

Rreth Boga & Associates

Boga & Associates, e themeluar në vitin 1993, është një firmë ligjore që operon e shquar në Shqipëri dhe Kosovë, e cila njihet për ofrimin e cilësisë më të lartë të shërbimeve ligjore, fiskale dhe kontabël për klientët e saj duke fituar një reputacion të fortë për ofrimin e cilësisë më të lartë të shërbimeve ligjore, tatimore dhe kontabël për klientët e saj. Me ekspertizë në fusha të ndryshme, duke përfshirë të drejtën e korporatave dhe tregtare, bankat dhe financat, ligjin tatimor, M&A, prokurimet, koncesionet dhe PPP-të, punësimin, pronësinë intelektuale, pasuritë e paluajtshme dhe çështjet gjyqësore, firma ndihmon punon me një bazë të larmishme klientësh, duke përfshirë kompanitë e Fortune 500, institucione udhëheqëse të rëndësishme financiare, kompani në industri të ndryshme dhe organizata që përfshijnë industri, si energjia, infrastruktura, teknologjia, telekomunikacioni, turizmi, kujdesi shëndetësor, etj.

Boga & Associates vlerësohet ndërkombëtarisht në fushat ligjore dhe fiskale dhe vazhdimisht kryeson renditjen në publikime të ndryshme prestigjioze.

Boga & Associates vlerësohet shumë në profesionin ligjor dhe tatimor, duke mbajtur një histori të qëndrueshme të renditjes së nivelit 1 nëpër drejtoritë dhe publikimet e njohura ndërkombëtare. Renditet në krye të klasifikimit Firma njihet si një firmë e nivelit të lartë në Chambers Global (2023), Chambers Europe (2023), The Legal 500 (2023), IFLR1000 (2023), ITR World Tax (2024) dhe World Trademark Review (2023).

E njohur për punën dhe përkushtimin e saj për t'u ofruar klientëve shërbimin më cilësor, firma është një emër i besuar në industrinë ligjore.

Rreth Deloitte Legal Shqipëri dhe Kosovë

Deloitte Legal sh.p.k është studio ligjore me seli në Tiranë, Shqipëri dhe me zyra në Prishtinë, Kosovë. Prioriteti më i madh i studios është t'i shërbejë klientëve të saj me kompetencë dhe ekspertizën e duhur. Pjesëtarët e Deloitte Legal punojnë ngushtë me profesionistët e Deloitte për tatimet, konsulencën, kontabilitetin, dhe këshillimin financiar në tregun vendas dhe ndërkombëtar, duke u siguruar klientëve shërbime profesionale këshillimi të plota.

Portofoli i firmës përfshin shoqëri vendase dhe shumëkombëshe, organizata jofitimprurëse, organe qeveritare, etj. Fushat e saj të punës përfshijnë ndër të tjera ato të së drejtës tregtare dhe të korporatës, M&A, ndërgjyqësi, bankë dhe financë, prokurime, koncesione dhe PPP, punësim, energji, pronësi intelektuale, mbrojtje të dhënash, konkurrencë, ndërtim dhe prona të paluajtshme, telekomunikacion, mjedis, etj.

Studioja renditet ndër të parat në tregun shqiptar nga “The Legal 500” dhe Chambers & Partners, dhe është e pranishme gjithnjë e më e fuqishme në tregun vendas.

SHKURTIME DHE SHKURTESA

AK – Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës
AIDA – Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
TDI – Traktat Dypalësh për Investimet
CEFTA- Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Evropës Qendrore
CIPE– Qendra për Ndërmarrjet Private Ndërkombëtare
CIFIOUS – Komiteti për Investimet e Huaja i Shteteve të Bashkuara
KE- Komisioni Evropian
ZPEA – Zona e Përbashkët Evropiane e Aviacionit
GJED – Gjykata Evropiane e Drejtësisë
ZEE- Zona Ekonomike Evropiane
EFTA- Shoqata Evropiane e Tregtisë së Lirë
BE- Bashkimi Evropian
IHD – Investimet e Huaja Direkte
TDB – Trajtim i Drejtë dhe i Barabartë
MNI – Marrëveshja Ndërkombëtare e Investimeve
INSTAT – Instituti Shqiptar i Statistikave
MZMISH – Mekanizmi i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve Investitor-Shtet
MSHI – Mekanizmat për Shqyrtimin e Investimeve
TVF – Trajtimi i vendit më të favorizuar
NHSH – Ndërmarrjet e Huaja Shumëkombëshe
NATO- Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut
PKK – Pikat Kombëtare të Kontaktit
TK – Trajtimi Kombëtar
OECD – Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
OZHQ – Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm
TAP – Gazsjellësi Trans Adriatik
UNCTAD – Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin

LISTA E GRAFIKËVE, TABELAVE, KUTIVE DHE SHTOJCAVE

Grafiku 1- Aplikimi i MSHI-ve

Grafiku 2 – Aktiviteti i Shteteve Anëtare në lidhje me shqyrtimin e FDI-ve

Grafiku 3- Fluksi hyrës i IHD-ve në vendet e Ballkanit Perëndimor, në milionë dollarë

Grafiku 4 - Fluksi hyrës i IHD-ve si % e PBB-së në vendet e Ballkanit Perëndimor

Grafiku 5 - Fluksi hyrës i IHD-ve në Shqipëri për periudhën 2015-2022, në milionë euro

Grafiku 6 - Fluksi hyrës i IHD-ve në Shqipëri si % e PBB-së për periudhën 2015-2022, në milionë euro

Grafiku 7 - IHD-të si % e PBB-së së Shqipërisë krahasuar me Investimet Publike si % e PBB-së

Grafiku 8 – Fluksi hyrës i IHD-ve për sektor në Shqipëri për vitin 2022

Grafiku 9 – Stoku i IHD-ve sipas sektorëve ekonomik në Shqipëri për vitin 2022

Grafiku 10 – Stoku i IHD-ve në Shqipëri për periudhën 2015-2022, në milionë euro

Grafiku 11 – Raporti i stokut të IHD-ve ndaj PBB-së së Shqipërisë për periudhën 2015-2022

Grafiku 12 – Pesë vendet kontribuuese kryesore të fluksit të IHD-ve në Shqipëri në vitin 2022, në milionë euro

Grafiku 13 – Pesë vendet e origjinës kryesore të stokut të IHD-ve në Shqipëri (si % e totalit të stokut)

Tabela 1 - Preferencat fillestare kombëtare për MSHI-të në mbarë BE-në

Tabela 2- Zhvillimet ligjore të Shteteve Anëtare të BE-së në lidhje me MSHI-të

Tabela 3- Cilësitë e IHD-ve sipas grupit të qëndrueshmërisë dhe rezultateve

Tabela 4 - Kapitali gjërryes dhe kapitali i strukturuar

Tabela 5 - Treguesit e kapitalit gjërryes dhe të strukturuar

Kutia 1- MSHI-të në Shtetet e Bashkuara

Kutia 2- Shembuj të zhvillimeve ligjore për MSHI-të në disa vende të BE-së

Kutia 3- Porti i Hamburgut, Gjermani

Kutia 4- Transferimi i teknologjisë, Itali

Kutia 5- Zgjerimi i mekanizmave të shqyrtimit të IHD-ve në më shumë juridiksione

Kutia 6- Pse Shqipëria konsiderohet vend miqësor për investime?

Kutia 7- Sektorët Strategjikë Ekonomikë në Shqipëri

Kutia 8- Shembull i shqyrtimit sektorial

Kutia 9- Kufizimi i pronësisë së medias është antikushtetues

Shtojca 1- Mekanizmat e shqyrtimit të IHD-ve në disa juridiksione

Shtojca 2- Modeli gjerman

I. Kuadri i përgjithshëm

Ky dokument trajton zhvillimet dhe prirjet më të fundit që lidhen me mekanizmat e shqyrtimit të investimeve (MSHI) në nivel ndërkombëtar, duke u përqendruar veçanërisht në vendet e BE-së. Metodologjia e zbatuar bazohet në studimin gjithëpërfshirës të *acquis*-së së BE-së dhe akteve ligjore dhe nënligjore vendase, si dhe të raporteve ndërkombëtare nga institucione me reputacion të mirë, të cilat trajtojnë Investimet e Huaja Direkte (IHD), si UNCTAD, OECD, BE, etj. Me qëllim saktësinë e të dhënave të përfshira në dokument, citohen vetëm dokumentet zyrtare, raportet e Komisionit Evropian (KE) dhe burime të besueshme informacioni dhe studimi, si Instituti CELIS në Berlin dhe CIPE. Ky punim kërkimor ka kufizimet e veta. Ai bazohet në qasje teorike, për shkak të mungesës së mekanizmave zyrtarë të shqyrtimit të investimeve në Shqipëri. Nuk u arrit identifikimi i asnjë akti të botuar zyrtarisht lidhur me shqyrtimin e mundshëm të investimeve lidhur me raste konkrete. Megjithatë, këto kufizime nuk ndikojnë rekomandimet e dhëna, duke qenë se ato pasqyrojnë shembuj të praktikave më të mira të zbatimit të mekanizmave të shqyrtimit të investimeve në juridiksione të tjera. Analiza tregon se numri i vendeve që vënë në zbatim regjime të reja shqyrtimi të investimeve dhe që ndryshojnë legjislacionin ekzistues është rritur. Kjo është kryesisht pasojë e faktorëve gjeo-ekonomikë dhe ndryshimit të legjislacionit të investimeve lidhur me IHD-të nga legjislacion me pengesa të pakta në legjislacion që trajton çështje të sigurisë kombëtare. Për më tepër, vendet që presin investime të rëndësishme po ndërgjegjësohen gjithnjë e më shumë jo vetëm sa i përket shifrave, por edhe cilësisë. Shpesh, kjo e fundit shihet si e lidhur më shumë me vendin e origjinës së investitorit dhe sektorin e veprimtarisë.

Rregullorja e BE-së 2019/452 përcakton një kuadër gjithëpërfshirës në nivel BE-je për shqyrtimin e IHD-ve mbi bazën e sigurisë ose rendit publik. Miratimi i saj dëshmon ndjeshmërinë e madhe të BE-së ndaj ndikimit të disa IHD-ve mbi *sigurinë kombëtare dhe rendin publik*. Rregullorja synon të sigurojë një kuadër bashkëpunimi në mbarë BE-në ndërmjet Vendeve Anëtare dhe Komisionit, si dhe të përcaktojë disa kriteret të përbashkëta për identifikimin e risqeve që lidhen me blerjen ose kontrollin e aseteve strategjike nga investitorë të huaj, të cilët mund të kërcënojnë sigurinë ose rendin publik.

Dispozitat e rregullores dhe MSHI-të e vëna në zbatim në një sërë Vendesh Anëtare të BE-së paraqesin mundësi për përmirësimin e legjislacionit për IHD-të edhe në Shqipëri, i cili aktualisht nuk përcakton mekanizma zyrtarë për shqyrtimin e investimeve. Me qëllimin për t'i paraprirë zhvillimeve të politikave që trajtojnë këtë mungesë, si dhe për të ofruar një sërë alternativash për politika të mundshme, më poshtë jepen një sërë rekomandimesh:

- ▶ Të krijohet hapësira për diskutim profesional dhe transparent për MSHI-të në nivel kombëtar;
- ▶ Të kryhet një analizë e thelluar e faktorëve të mundshëm gjeo-ekonomikë dhe prirjeve të IHD-së të cilat mund të rezultojnë në problematika për sigurinë kombëtare dhe rendin publik në kontekstin shqiptar;
- ▶ Të kryhet analizë e thelluar e kuadrit aktual ligjor dhe nënligjor për IHD-të, përfshirë çështje të qeverisjes, kapaciteteve institucionale dhe bashkërendimit;
- ▶ Të identifikohen praktikatat më të mira të MSHI-ve në nivelin e BE-së, dhe të zhvillohet më tej bazuar në përvojën e tyre dhe mësimet e marra;

- Qeveria duhet të vlerësojë ndikimet e Rregullores së BE-së 2019/452 në legjislacionin vendas dhe t'i japë përparësi ndërhyrjeve sipas objektivave të procesit të negociatave për anëtarësim që siguron pranim të shpejtë dhe të plotë të *acquis-së* së BE-së;
- Të fuqizohen Shoqatat e Biznesit dhe Dhomat e Tregtisë lidhur me rolin e tyre për të ndikuar në mënyrë të efektshme politikëbërjen dhe për t'i dhënë formë diskutimeve mbi IHD-të dhe MSHI-të.

Së fundmi, IHD-të janë jetike për ekonominë shqiptare. Në këtë kuadër, trajtimi i legjislacionit për IHD-të dhe shqyrtimin e tyre, nga këndvështrimi i qeverisë dhe ai i investitorëve të huajë të drejtpërdrejtë, duhet të garantojë shkallë të mirë të garancisë ligjore dhe parashikueshmëri për investitorët e huaj pa paragjykime. Për të arritur këtë qëllim, çdo ndërhyrje në legjislacionin për IHD-të ka nevojë për modele të qëndrueshme dhe rezistente të cilat janë vënë tashmë në zbatim të juridiksioneve të tjera me traditë të gjatë në mbajtjen e investitorëve të huaj në vend. Është e rëndësishme që këto modele të personalizohen sipas tipareve të IHD-ve në Shqipëri dhe që risqet e mundshme të flukseve të investimeve në hyrje të vlerësohen paraprakisht. Arritja e këtij objektivit kërkon medoemos konsultim publik përmes platformave të dialogut publik-privat.

II. ÇFARË JANË MEKANIZMAT PËR SHQYRTIMIN E IHD-VE

Vendet pritëse të investimeve kanë instrumente të ndryshme politikash për ushtrimin e së drejtës së tyre sovraane për rregullimin e hyrjes dhe zbatimit të investimeve të huaja në territorin e tyre.¹ Këto instrumente përfshijnë regjistrimin e biznesit dhe miratimin e kërkesave, si dhe ndalimin e pjesëmëm ose të plotë të investimeve të huaja në sektorë të caktuar të ekonomisë. Ndër të tjera, këto kufizime pasqyrojnë shqetësimet e lidhura me shqetësimet e vendeve pritëse lidhur me sigurinë kombëtare,² të hapura ose të nënkuptuara qofshin ato.

Pjesa më e madhe e vëmendjes dhe e fushëveprimit të politikave për mbrojtjen e interesave jetike të sigurisë përqendrohet aktualisht në ato politika që lidhen me blerjen dhe pronësinë, madje në veçanti tek MSHI-të.³ Këto instrumente trajtojnë ekspozimet, veçanërisht ato që lidhen me spiunazhin, sabotazhin, varësinë nga një furnitor i vetëm dhe rreziqe të ngjashme të investimeve hyrëse.⁴

2.1 Historia e mekanizmave për shqyrtimin e investimeve

Kufizimi i fluksit hyrës të IHD-ve me arsyetimin e mbrojtjes së interesave kombëtare është një tendencë në rritje për shkak të situatës gjeo-ekonomike.⁵ Kodi i Liberalizimit të Lëvizjes së Kapitalit i OECD-së parashikon kufizimin e IHD-ve *për shkak të ruajtjes së rendit publik dhe mbrojtjes së*

¹UNCTAD, "Investment Policy Monitor: National Security-Related Screening Mechanisms for Foreign Investment", dhjetor 2019. <https://investmentpolicy.unctad.org/publications/1213/investment-policy-monitor-special-issue---national-security-related-screening-mechanisms-for-foreign-investment-an-analysis-of-recent-policy-developments>. Parë për herë të fundit më 12.06.2023.

² Po aty.

³ <https://www.oecd.org/investment/investment-policy/investment-policy-national-security.htm>. Parë për herë të fundit më 12.06.2023.

⁴ OECD, "Investment Policy Developments Between 16 October 2020 and 15 October 2021", nëntor 2021.

<https://www.oecd.org/investment/investment-policy/Investment-policy-monitoring-October-2021-ENG.pdf>. Parë për herë të fundit më 12.06.2023.

⁵ Zakonisht termi nënkupton prirjen e presupozuar në marrëdhënie ndërkombëtare të shfrytëzimit të instrumenteve të politikave ekonomike për arritjen e qëllimeve të politikës së jashtme që lidhen me sigurinë ose gjeo-politikën. Blackwill, R. D., & Harris, J. M. (2016), "War by other means: Geoeconomics and Statecraft", Harvard University Press; J. Hillebrand Pohl "Geoeconomic Risks Associated with Foreign Investments", artikull i paraqitur në Simpoziumin e Institutit CELIS në vitin 2021.

*interesave themelore të sigurisë*⁶ që prej vitin 1961. Në thelb shqyrtimi i investimeve ka të bëjë me instrumentet dhe mekanizmat për të kontrolluar nëse një projekt i caktuar investimi është në përputhje me interesat strategjikë të vendit. Mekanizmat e shqyrtimit të IHD-ve dhe përcaktimi i interesave kombëtare⁷ si gur themeli për këto shqyrtime janë zhvilluar dhe zgjeruar me kalimin e kohës, duke rezultuar në konsiderimin e një sërë nënsektorëve të rinj të ekonomisë si strategjikë.⁸ Arsyet për këtë prirje do të diskutohen më tej më poshtë. SHBA-ja ka traditë të gjatë sa i përket vendeve që kanë ngritur mekanizma të shqyrtimit të investimeve.

KUTIA 1

MSHI-të në Shtetet e Bashkuara

Qeveria e Shteteve të Bashkuara ka nisur të kryejë shqyrtim e investimeve që prej vitit 1975. Kontrollat bëhen nga Komisioni për Investimeve e Huaja në Shtetet e Bashkuara (CFIUS).⁹ Nëse CFIUS-i vlerëson se një investim i caktuar mund të rrezikojë sigurinë kombëtare, ai mund t'ia referojë rastin për vendimmarrje Presidentit të SHBA-së. Vendimi i Presidentit është detyrues dhe nuk mund të ankimohet. Kuadri ligjor kryesor për instrumentin e shqyrtimit të investimeve të huaja u përmirësua në vitin 2018 me anë të "Aktit të Modernizimit të Vlerësimit të Rrezikut të Investimeve të Huaja."¹⁰ Ai përforcoi dhe fuqizoi CFIUS-in sa i përket trajtimit më të efektshëm të shqetësimeve lidhur me sigurinë kombëtare, përfshirë zgjerimin e autoritetit të Presidentit dhe CFIUS-së për shqyrtimin dhe marrjen e masave për trajtimin e shqetësimeve lidhur me sigurinë kombëtare, që rrjedhin nga investime të caktuara jokontrolluese dhe transaksione pasurish të paluajtshme që përfshijnë persona të huaj.¹¹ Më 15 shtator 2022, Presidenti Biden miratoi [Urdhri Ekzekutiv 14083](#) duke pasqyruar panoramën në zhvillim të kërcënimeve ndaj sigurisë kombëtare dhe duke theksuar rolin kritik të Komisionit për Investimet e Huaja në Shtetet e Bashkuara, në përgjigje të kërcënimeve dhe cenueshmërive të reja dhe në zhvillim e sipër në kontekstin e investimeve të huaja. Urdhri Ekzekutiv zhvillon më tej dhe zgjeron listën ekzistuese të faktorëve që CFIUS-i merr në konsideratë sipas rastit, tek shqyrton transaksionet për risqe të sigurisë kombëtare, dhe përshkruan implikimet e mundshme të sigurisë kombëtare në fusha kyçe.¹² Përveç shqyrtimit të investimeve *hyrëse*, në kuadër të një zhvillimit të kohëve të fundit, SHBA-ja ka vënë në funksion programin e ri "*Programi i Investimeve Jashtë Vendi*" (*Outbound Investment Program*), me qëllim

⁶ OECD (2023), OECD Code of Liberalisation of Capital Movements, www.oecd.org/investment/codes.htm. Parë për herë të fundit më 12.06.2023.

Kodi i Liberalizimit të Lëvizjes së Kapitalit u hartua për herë të parë nga OECD-ja në vitin 1961. Sipas këtij dokumenti, vendet pjesëmarrëse kanë pranuar detyrime ligjore në fushën e flukseve të kapitalit. Në Nenin 3, "Rendi publik dhe siguria" përcaktohet se:

Dispozitat e këtij Kodi nuk e parandalojnë një Anëtar të ndërmarrë veprime që i konsideron të nevojshme për:

- i) ruajtjen e rendit publik ose mbrojtjen e shëndetit publik, moraleve dhe sigurisë;
- ii) mbrojtjen e interesave të veta themelore të sigurisë;
- iii) përmbushjen e detyrimeve të veta lidhur me paqen dhe sigurinë ndërkombëtare.

⁷ Megjithëse në juridiksione të ndryshme përdoren një sërë nuancash dhe terminologjish, në përgjithësi interesat kombëtare i referohen dhe/ose nënkuptojnë çështje që lidhen me rendin publik, sigurinë kombëtare, infrastrukturën kritike, sektorët strategjikë, etj. Sipas UNCTAD-it, arsyetimi i shqyrtimit të investimeve bazohet në "rendin publik" si kriterin kryesor për ndërmarrjen e shqyrtimit në 11 vende, ndërkohë që "siguria kombëtare" dhe "interesi kombëtar" jepen si arsyetimi kryesor në 6 dhe 5 vende përkatësisht.

⁸ UNCTAD, "Investment Policy Monitor: The Evolution of FDI Screening Mechanisms", shkurt 2023. Parë për herë të fundit më 12.06.2023.

⁹ CFIUS-i është komision ndërinstucional i autorizuar të shqyrtojë transaksione të caktuara që përfshijnë investimet e huaja në Shtetet e Bashkuara dhe transaksione të caktuara pasurish të paluajtshme nga persona të huaj, me qëllim përcaktimin e efektit të këtyre transaksioneve mbi sigurinë kombëtare të Shteteve të Bashkuara.

¹⁰ <https://home.treasury.gov/policy-issues/international/the-committee-on-foreign-investment-in-the-united-states-cfius/cfius-laws-and-guidance>. Parë për herë të fundit më 30.05.2023

¹¹ <https://home.treasury.gov/policy-issues/international/the-committee-on-foreign-investment-in-the-united-states-cfius>. Parë për herë të fundit më 30.05.2023


¹² Po aty.

shqyrtimin dhe ndalimin e disa investimeve *dalëse* nga SHBA-ja.¹³ Urdhri Ekzekutiv Presidential 14105 i datës 9 gusht 2023 deklaroi emergjencë kombëtare për trajtimin e kërcënimit ndaj Shteteve të Bashkuara që vjen nga disa vende problematike, të cilat synojnë të zhvillojnë dhe shfrytëzojnë teknologji dhe produkte të ndjeshme ose të përparuara që janë kritike për ushtrinë, inteligjencën, mbikëqyrjen ose aftësitë e mundësuar nga kibernetika.¹⁴

Vende të tjera kanë vijuar të miratojnë rregulla që lidhen me shqyrtimin e IHD-ve, dhe që lejojnë veprimet e nevojshme për kufizimin e investimeve të caktuara që konsiderohet se janë në kundërshtim me interesat kombëtare.¹⁵ Numri i vendeve që vënë në zbatim regjime të reja të shqyrtimit është rritur vazhdimisht gjatë dhjetëvjeçarit të fundit dhe kjo prirje nuk u ndryshua as nga pandemia, përkundrazi ky numër u rrit më shpejt. Sipas UNCTAD-it, në periudhën 1995 - 2022, të pakën 37 vende kanë vënë në zbatim kuadro të reja ligjore për shqyrtimin e investimeve që përfshijnë konsiderata lidhur me sigurinë kombëtare. Nga këto 37 vende që kanë vënë në zbatim shqyrtimin e investimeve për sigurinë kombëtare, gjatë periudhës së studiuar, 22 prej tyre ishin ekonomi të zhvilluara evropiane. Në rajone të tjera, këto legjislacione përdoren vetëm nga disa vende të zhvilluara dhe në zhvillim (nëntë vende në Azi, dy në Amerikën e Veriut, dy në Oqeani, një në Amerikën Latine dhe një në Afrikë).¹⁶

Veprimtaria legjislative kulmoi në vitin 2020, kur ekonomia botërore u përball me risqet e lidhura me pandeminë e shkaktuar nga COVID-19 (Grafiku 1). Ku moment përkon me miratimin e Rregullores së BE-së për Shqyrtimin e Investimeve, që hyri në fuqi të plotë që prej 11 tetorit 2020.

Grafiku 1 – Aplikimi i MSHI-ve



Burimi: Monitori i Politikave të Investimeve të UNCTAD

¹³ Urdhër Ekzekutiv i Presidentit të SHBA-së nr. 14105 datë 9 gusht 2023. ¹³Parë për herë të fundit më 12.06.2023

¹⁴ <https://home.treasury.gov/policy-issues/international/outbound-investment-program>. Parë për herë të fundit më 12.06.2023.

¹⁵ Franca e përmirësoi legjislacionin e vet në vitin 2005. Në vitin 2006, Kina miratoi legjislacion që autorizonte qeverinë të parandalonte investime që mund të kishin ndikim negativ në sigurinë kombëtare.

¹⁶ UNCTAD, "Investment Policy Monitor: The Evolution of FDI Screening Mechanisms", February 2023. Parë për herë të fundit më 12.06.2023.

III. SHQYRTIMI I INVESTIMEVE NË BE

3.1. Kuadri historik dhe konteksti

3.1.1. Nevoja për trajtimin e rrezikut gjeo-ekonomik

Më 13 shtator 2017, Komisioni botoi një propozim për një rregullore që do të përcaktonte kuadrin ligjor për shqyrtimin e IHD-ve hyrëse në BE. Ndër të tjera, propozimi përfshinte sa më poshtë:

- hartimin e një kuadri ligjor mundësues që përqafojë diversitetin e qasjeve të Vendeve Anëtare ndaj shqyrtimit të IHD-ve dhe përgjegjësinë e tyre ekskluzive për siguri kombëtare, ndërkohë që merrte në konsideratë kompetencën e BE-së për IHD-të;
- rikonfirmimin që Vendet Anëtare mund të ruajnë, ndryshojnë ose miratojnë mekanizma për shqyrtimin e IHD-ve mbi bazën e sigurisë ose rendit publik sipas kushteve të Rregullores së propozuar, dhe që Vendet Anëtare nuk do të ishin të detyruara të krijojnë mekanizma për shqyrtimin e IHD-ve dhe së ato rezervojnë pushtetin e tyre përfundimtar vendimmarrës për IHD-të;
- vënien në zbatim të një kompetence të re të Komisionit për shqyrtimin e IHD-ve dhe për nxjerrjen e një mendimi jodetyrues nëse (i) një IHD në një vend anëtar mund të ndikojë sigurinë ose rendin publik të projekteve ose programeve në “interes të Bashkimit”; (ii) një IHD në një vend anëtar mund të ndikojë sigurinë ose rendin publik të vendeve të tjera anëtare;
- krijimin e mekanizmit të bashkëpunimit ndërmjet vendeve anëtare dhe Komisionit, që synon të përforcojë bashkërendimin e vendimeve të shqyrtimit të investimeve të marra nga Vendet Anëtare në fjalë, si dhe të ndërgjegjësojë më tej vendet anëtare dhe Komisionin lidhur me IHD-të e planifikuara ose të përfunduara që mund të ndikojnë sigurinë ose rendin publik përmes shkëmbimit të informacionit;
- vënien në zbatim të kërkesave për transparencë dhe informacion për vendet anëtarë që bëjnë dhe nuk bëjnë shqyrtim të investimeve, lidhur me këtë mekanizëm të ri bashkëpunimi.

Për më tepër, Komisioni kreu një vlerësim të situatës aktuale të IHD-ve në BE. Ky vlerësim nxori në pas¹⁷ sa vijon: (i) Investitorët kryesorë tradicionalë në BE dhe ekonomitë e përparuara si SHBA-të, Zvicra, Norvegjia, Kanadaja, Australia e Japonia vijojnë të kryesojnë dukshëm dhe të kontrollojnë më shumë se 80% të të gjitha aktiveve nën pronësi nga të huaj; (ii) Dalin në pah “investitorë të rinj”. Larmia e vendeve të origjinës së kapitalit ka njohur vetëm rritje dhe kjo është realizuar përmes një sërë blerjesh duke rritur numrin e marrëveshjeve, përgjatë viteve të fundit siç janë, për shembull, nga Kina në sektorin e prodhimit të avionëve dhe makinerive të specializuara, ose nga India në sektorin farmaceutik. Gjithashtu, prania e Ruisë dhe Emirateve të Bashkuara Arabe me anë të disa blerjeve; (iii) “Investitorët Offshore” ishin një gjetje surprizë e studimit. Ata kontrollojnë 11% të shoqërive evropiane nën pronësi të huaj dhe një pjesë të konsiderueshme të aktiveve nën pronësi nga të huaj (4%) në BE.

Këto zhvillime nxitën një ndjeshmëri të shtuar tek disa qeveri brenda BE-së karshi depërtimit në sektorët strategjikë nga ana e aktorëve të vendeve të treta të kontrolluar dhe subvencionuar nga shtetet dhe jo nga shoqëritë tregtare private dhe ndaj mungesës së mekanizmave të përshtatshëm të shqyrtimit në disa vende të tjera të BE-së.

Në shkurt 2017, përmes një letre publike, Franca, Gjermania dhe Italia i kërkuan KE-së të rishqyrtojë rregullat për investimet e huaja në BE, për shkak të shqetësimeve lidhur me rrjedhjen jashtë vendit të njohurive teknologjike. Në fillim të vitit 2016, Gjermania u përball me këto probleme kur shoqëria kineze Midea bleu kampionin e saj kombëtar të robotikës, Kuka, për 5,3 miliardë dollarë.¹⁸ Në një rast të mëparshëm të vitit 2016, autoritetet gjermane kishin shqyrtuar përthithjen e shoqërisë me seli në gjermani Aixtron SE, një firmë gjermane që prodhon gjysmëpërçues, nga disa investitorë kinezë.¹⁹ Më vonë, po atë vit, Presidenti Obama miratoi një urdhër ekzekutiv, i cili²⁰ urdhëronte pengimin e blerjes së propozuar të Aixtron, Inc., një degë amerikane e Aixtron, me seli në Kaliforni. Komiteti për Investimet e Huaja i Shteteve të Bashkuara (CFIUS) kishte rekomanduar që transaksioni të mos autorizohet. Mesa duket, disa vende patën një lloj bashkëpunimi për marrjen e një vendimi të tillë, megjithëse zyrtarisht ishte deklaruar se shqyrtimet janë të pavarura.²¹

Letra i referohej një numri në rritje të investitorëve me origjinë jo nga BE-ja, të cilët blinin teknologji evropiane për objektiva strategjike të vendeve të tyre të origjinës, si dhe faktit që investitorët e BE-së shpesh përballëshin me barrierë, kur ata përpiqeshin të investonin në vende të tjera, duke theksuar mungesën e reciprocitetit nga vendet e treta.²²

“Po, Evropa është e hapur për biznes. Por duhet të ketë reciprocitet. Duhet të marrim atë që japim.... Më lejoni të them një herë e mirë se: ne nuk jemi tregtarë të lirë e naivë. Evropa duhet të mbrojë gjithmonë interesat e saj strategjike. Kjo është arsyeja pse sot ne propozojmë një kuadër të ri të BE-së për shqyrtimin e investimeve. Nëse një shoqëri e huaj, shtetërore, dëshiron të blejë një port evropian, një pjesë të infrastrukturës sonë të energjisë, ose një firmë të teknologjisë së mbrojtjes, kjo duhet të ndodhë vetëm në mënyrë transparente, pas zhvillimit të një shqyrtimi dhe debati. Është përgjegjësi politike të dimë se çfarë po ndodh në oborrin e shtëpisë tonë në mënyrë që të mund të mbrojmë sigurinë tonë në mënyrë kolektive, nëse është e nevojshme.”²³

Jean-Claude Juncker, Ish-President i Komisionit Evropian

Përmes këtij fjalimi drejtuar KE-së nga Jean-Claude Juncker, në atë kohë President i KE-së, nisi zyrtarisht një proces politikash për shqyrtimin e IHD-ve që hynin në Evropë.

3.1.2. Zhvendosja e fokusit të legjislacionit për investimet

Zhvillime të tilla shënuan një zhvendosje të fortë në trendin e politikave dhe qasjeve ndaj IHD-ve, nga regjimet liberale të investimeve që përqendroheshin tek investitorët dhe barrierat e ulëta, tek mekanizmat e shqyrtimit të investimeve që përqendrohen në ndjeshmërinë e qeverisë për të mbrojtur vendet e tyre nga dëmtimet e mundshme të sigurisë kombëtare që mund të vijnë nga pronësia e huaj e industrive dhe aktiveve të ndjeshme.²⁴ Në fakt, sipas Komisionit, në vitin 2019, BE-ja kishte një nga regjimet më të hapura për investimet në botë, e pranuar edhe nga OECD-ja në indeksin e saj për kufizimin e investimeve. BE-ja është destinacioni kryesor i IHD-ve në botë. Aksionet

¹⁸ <https://www.reuters.com/article/kuka-ma-midea-group-germany-idCNL5N18G482>. Parë për herë të fundit më 30.05.2023.

¹⁹ [Frankfurter Allgemeine Zeitung](https://www.frankfurter-allgemeine-zeitung.com). Parë për herë të fundit më 12.06.2023.

²⁰ <https://obamawhitehouse.archives.gov/the-press-office/2016/12/02/presidential-order-regarding-proposed-acquisition-controlling-interest> Parë për herë të fundit më 12.06.2023.

²¹ [Adresa në internet e Reuters](https://www.reuters.com). Parë për herë të fundit më 12.06.2023.

²² Shërbimi i Kërkimit i Parlamentar Evropian, Kuadri i BE-së për shqyrtimin e IHD-ve, Bruksel, Parlamenti Evropian, prill 2019. [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/ATAG/2019/633165/EPRS_ATA\(2019\)633165_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/ATAG/2019/633165/EPRS_ATA(2019)633165_EN.pdf). Parë për herë të fundit më 31.05.2023.

²³ Jean-Claude Juncker, Trajtimi i gjendjes së Bashkimit 2017. Bruksel: Komisioni Evropian, 13 shtator. https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/SPEECH_17_3165 Qasja e fundit më 31.05.2023.

²⁴ “Formimi i politikës së sigurisë së investimeve: një udhëzues për shoqatat e biznesit”, Sarah Bauerle Danzman, Qendra për Ndërmarrjet Private Ndërkombëtare (CIPE), 2023.

<https://www.cipe.org/resources/shaping-investment-security-policy-a-guide-for-business-associations/>. Parë për herë të fundit më 29.05.2023.

e IHD-ve që zotërohen nga investitorë me origjinë nga vendet e treta në BE arritën në 6 295 miliardë euro në fund të vitit 2017, duke iu siguruar evropianëve 16 milionë vende pune të drejtpërdrejta.²⁵ Faktorët përcaktues për mbështetjen ndaj MSHI-ve në përgjithësi, dhe në rastin e BE-së në veçanti, janë një kombinim i aspekteve tregtare, ekonomike, institucionale dhe të sigurisë kombëtare.²⁶ Në fakt, ato nxiten nga shqetësimet në rritje si nga investitorët vendas ashtu edhe nga qeveritë për blerjen nga investitorët e huaj të teknologjisë dhe njohurive vendase, të tilla si inteligjenca artificiale, robotika, gjysmëpërçuesit, cloud computing, 5G, teknologjia kuantike, hardueri informatik, nanoteknologjitë, bioteknologjitë ose satelitët dhe hapësira ajrore. Ndër disa arsye që mund të shpjegojnë zhvillime të tilla sipas UNCTAD-it, duket se lidhen drejtpërdrejt me sigurinë/interesat kombëtare:

“...shtrirja e sferës së veprimit të shqyrtimit është pjesërisht edhe një reagim ndaj rritjes së aktiviteteve investuese të ndërmarrjeve të huaja shtetërore apo të kontrolluara nga shteti dhe e fondeve të pasurisë sovrane. Ka shqetësime se këto aktivitete mund të rezultojnë në kontrollin e shtetit të huaj mbi shoqëritë kryesore ose infrastrukturën kritike.”²⁷

Disa studime tregojnë se jo të gjitha shtetet e BE-së kanë mbështetur MSHI-të në mbarë BE-në. Dëshmitë tregojnë se

“cit. niveli teknologjik i vendit është përcaktuesi më i rëndësishëm i preferencave kombëtare për shqyrtimin e IHD-ve. Vendet me nivele më të larta teknologjike janë më të shqetësuara për transferimin ndërkombëtar të pakthyeshem të teknologjive, veçanërisht atyre strategjike.”²⁸ Megjithatë, disa faktorë si gjeopolitika, gjeonomia dhe faktorë të tjerë që lidhen me diplomacinë ekonomike luajtën të gjithë një rol, duke marrë parasysh se vende të ndryshme brenda BE-së kanë/kishin pikëpamje të ndryshme në lidhje me investimet nga vende si Kina ose Rusia.

Tabela 1 - Preferencat fillestare kombëtare për MSHI-të në mbarë BE-në

KUNDËRSHTUAN	DISI KUNDËRSHTUAN	NEUTRAL	DISI MBËSHTETËN	MBËSHTETËN
<p>Qipro Estoni Greqi Hungari Irlandë Maltë Portugali Mbretëria e Bashkuar</p>	<p>Belgjikë Çeki Finlandë Letoni Luksemburg Holandë Rumani Suedi</p>	<p>Bullgari Kroaci Sllovaki Slloveni</p>	<p>Danimarkë Lituani Spanjë</p>	<p>Austri Francë Gjermani Itali Poloni</p>

Burimi: “Prapa skenës: si të kuptojmë mbështetjen kombëtare për një mekanizëm për shqyrtimin e investimeve të huaja në Bashkimin Evropian”

²⁵ Njoftim për shtyp i Komisionit Evropian, 10 prill 2019.

https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/IP_19_2088. Parë për herë të fundit më 31.05.2023.


²⁶ “Prapa skenës: si të kuptojmë mbështetjen kombëtare për një mekanizëm për shqyrtimin e investimeve të huaja në Bashkimin Evropian”, Zenobia T. Chan & Sophie Meunier. *Rishikim i organizatave ndërkombëtare*. Publikuar: 13 korrik 2021, <https://link.springer.com/article/10.1007/s11558-021-09436-y#citeas>. Parë për herë të fundit më 29.05.2023.

²⁷ UNCTAD, "Monitorimi i politikës së investimeve: Mekanizmat e shqyrtimit mbi bazën e sigurisë kombëtare për investimet e huaja", dhjetor 2019. <https://investmentpolicy.unctad.org/publications/1213/investment-policy-monitor-special-issue---national-security-related-screening-mechanisms-for-foreign-investment-an-analysis-of-recent-policy-developments>. Parë për herë të fundit më 12.06.2023.

²⁸ “Prapa skenës: si të kuptojmë mbështetjen kombëtare për një mekanizëm për shqyrtimin e investimeve të huaja në Bashkimin Evropian”, Zenobia T. Chan & Sophie Meunier. *Rishikim i organizatave ndërkombëtare*. Publikuar: 13 korrik 2021, <https://link.springer.com/article/10.1007/s11558-021-09436-y#citeas>. Parë për herë të fundit më 29.05.2023.

3.2. Shpjegim i shkurtër i Rregullores 2019/452²⁹

3.2.1. Premisat dhe arsyetimi ligjor



Para hyrjes në fuqi të rregullores, nuk kishte asnjë kuadër gjithëpërfshirës, në nivel BE-je, për shqyrtimin e IHD-ve për arsyen e sigurisë ose rendit publik, ndërsa partnerët kryesorë tregtarë të BE-së kishin zhvilluar tashmë korniza të ngjashme. Qëllimi i rregullores është të balancojë hapjen e BE-së ndaj IHD-ve me anë të mjeteve të përshtatshme shqyrtuese, me qëllim mbrojtjen e sigurisë dhe rendit publik. Baza ligjore e rregullores është neni 207(2) i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian³⁰ për masat që përcaktojnë kuadrin e zbatimit të politikës së përbashkët tregtare.³¹ KE-ja ka sqaruar disa herë se rregullorja nuk ka në fokus asnjë vend të caktuar. Shqetësimet në lidhje me sigurinë dhe rendin publik mund të lindin prej shumë aspektesh. Trajtimi pa diskriminuar mes investitorëve të huaj (jo të BE-së) është një parim kryesor i rregullores dhe bazat e vetme për shqyrtimin e një investimi të huaj janë rreziqet ndaj sigurisë dhe rendit publik, të vlerësuara rast pas rasti, pavarësisht origjinës së investitorit të huaj.³²

Rregullorja përbën një akt ligjor të BE-së dhe është e detyrueshme dhe e zbatueshme drejtpërdrejt në të gjitha Shtetet Anëtare, megjithatë, ka njëanshmëri në lidhje me efektivitetin e saj, duke marrë parasysh se rregullorja nuk u imponon Shteteve Anëtare krijimin e një mekanizmi shqyrtimi të investimeve. Sistemi i njoftimit dhe shkëmbimit të mendimeve nuk zbatohet për Shtetet Anëtare që nuk kanë mekanizmin e tyre kombëtar. Rregullorja konfirmon se vendimi nëse do të ngrihet një mekanizëm kombëtar për shqyrtimin dhe të përcaktohet sfera e veprimit dhe procesi i tij, ose, nëse ekziston një mekanizëm kombëtar shqyrtimi, a do të shqyrtohet një investim i huaj i drejtpërdrejtë i caktuar apo jo, do të mbetet përgjegjësi ekskluzive e atij shteti anëtar ku është planifikuar ose ka përfunduar investimi. Megjithëse nuk ka asnjë detyrim ligjor për ta bërë këtë, të gjitha Shtetet Anëtare ftohen të kenë një mekanizëm shqyrtimi të plotë.³³ Rregullorja hyri në fuqi më 10 prill 2019 dhe u bë plotësisht e zbatueshme më 11 tetor 2020.

3.2.2 Përkufizimi i mekanizmit të shqyrtimit



Mekanizmi i shqyrtimit nënkupton një instrument me zbatim të përgjithshëm, siç është ligji ose rregullorja, si dhe kërkesat administrative plotësuese, rregullat ose udhëzimet zbatuese, që përcaktojnë termat, kushtet dhe procedurat për vlerësimin, hetimin, autorizimin, kushtëzimin, ndalimin ose zhbërjen e IHD-ve për

²⁹Rregullorja (BE) 2019/452 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 19 mars 2019 që përcakton një kuadër për shqyrtimin e investimeve të huaja direkte në BE [2019] OJ L791/1 (Rregullorja për shqyrtimin e IHD-ve në BE)

<https://eur-lex.europa.eu/eli/reg/2019/452/oj>. Parë për herë të fundit më 12.06.2023.

³⁰ "Rregullorja për shqyrtimin e IHD-ve në BE", hyrje <https://eur-lex.europa.eu/eli/reg/2019/452/oj>. Parë për herë të fundit më 12.06.2023

³¹ Cit. "Parlamenti dhe Këshilli, duke vepruar me anë të rregulloreve në përputhje me procedurën e zakonshme legjislativë, miratojnë masat që përcaktojnë kuadrin e zbatimit të politikës së përbashkët tregtare".

³² Pyetjet më të shpeshta për Rregulloren (BE) 2019/452 që përcakton një kuadër për shqyrtimin e investimeve të huaja direkte në BE, 21 qershor 2021.

<https://circabc.europa.eu/ui/group/be8b568f-73f3-409c-b4a4-30acfcec5283/library/7c76619a-2fcd-48a4-8138-63a813182df2/details>. Parë për herë të fundit më 12.06.2023.

³³ Udhëzimet e KE-së 2020. https://www.skadden.com/-/media/files/publications/2020/03/covid19-early-effects-on-foreign-investment/pdf_tradoc_158676.pdf?rev=1814f7de4aee48908e63280cce0b3912&hash=5C8EA4EEFF2B216F62214A52D7D30EA6. Parë për herë të fundit më 12.06.2023.

arsye të sigurisë ose të rendit publik. Gjithashtu, lidhur me parashikimin e nenit 1, pika 1³⁴, duhet të specifikohet se rregullorja zbatohet vetëm për IHD-të dhe transaksionet që mund të ngrenë shqetësime vetëm për sigurinë dhe rendin publik.

3.2.3 Përkufizimi i sigurisë dhe rendit publik



Rregullorja nuk jep shprehimisht një përkufizim për “sigurinë” dhe “rendin publik”. Interpretimi dhe përkufizimet e tyre janë në diskrecion të Shteteve Anëtare. Përkundrazi, ajo parashikon një listë jo shteruese të sektorëve të ndjeshëm dhe faktorëve të tjerë përkatës (faktorët që bëhen shkas për shqyrtimin), tek të cilët mund të përqendrohen Shtetet Anëtare dhe Komisioni gjatë përcaktimit nëse një IHD ka të ngjarë të ndikojë mbi sigurinë ose rendin publik.

3.2.4 Faktorët që bëhen shkas për shqyrtimin dhe ndërveprimi i rregullores me ligjet kombëtare



Neni 4 (1) jep listën e faktorëve që mund të bëhen shkas për shqyrtimin nga ana e Shteteve Anëtare. Ai u referohet kriterëve, të tilla si: (i) infrastruktura kritike, qoftë fizike ose virtuale, duke përfshirë energjinë, transportin, ujin, shëndetin, komunikimet, median, përpunimin ose ruajtjen e të dhënave, hapësirën ajrore, mbrojtjen, infrastrukturën zgjedhore ose financiare, si dhe objektet e ndjeshme, si dhe tokën e pasuritë e paluajtshme të qenësishme për përdorimin e kësaj infrastrukture; (ii) teknologjitë kritike dhe artikujt me përdorim të dyfishtë, duke përfshirë inteligjencën artificiale, robotikën, gjysmëpërçuesit, sigurinë kibernetike, hapësirën ajrore, mbrojtjen, ruajtjen e energjisë, teknologjitë kuantike dhe bërthamore, si dhe nanoteknologjitë dhe bioteknologjitë; (iii) furnizimi i lëndëve primare jetike, duke përfshirë energjinë ose lëndët e para, si dhe sigurinë ushqimore; dhe (iv) qasja në informacion të ndjeshëm, duke përfshirë të dhënat personale ose aftësia për të kontrolluar një informacion të tillë, apo liria dhe pluralizmi i medias.

Karakterit jo detyrues dhe jo i detyrueshëm i këtyre faktorëve për Shtetet Anëtare mund të dalë në pah nga formulimi i nenit 4(2). Shtetet Anëtare janë të lirë të vendosin nëse do të lejojnë që në legjislacionin e tyre të brendshëm të parashikohen faktorë shtesë për t'u vlerësuar. Neni 4(2), megjithëse lejon të njëjtin diskrecion për Shtetet Anëtare, parashikon më tej se gjatë përcaktimit nëse një IHD ka të ngjarë të ndikojë mbi sigurinë ose rendin publik, Shtetet Anëtare dhe Komisioni mund të marrin parasysh gjithashtu nëse investitori i huaj kontrollohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga qeveria e një vendi të tretë, duke përfshirë financime të konsiderueshme të mbështetura nga shteti dhe jo nga pronësia e drejtpërdrejtë.

3.2.5 Mospasja e një pragu minimal



Në kundërshtim me legjislacionin e shumë Shteteve Anëtare, si Gjermania dhe Franca, rregullorja nuk vendos asnjë prag minimal për shqyrtimin e IHD-ve, as në bazë të shumës totale dhe as në lidhje me aksionet e korporatave.

³⁴ “1. Kjo rregullore përcakton një kuadër për shqyrtimin nga Shtetet Anëtare të investimeve të huaja direkte në BE për shkak të sigurisë ose rendit publik dhe për një mekanizëm bashkëpunimi mes Shteteve Anëtare, dhe mes Shteteve Anëtare dhe Komisionit, në lidhje me investimet e huaja direkte që mund të kenë ndikim tek sigurinë ose rendin publik. Këtu përfshihet mundësia që Komisioni të japë opinione për këto investime”.

3.2.6 Krijimi i një mekanizmi bashkëpunimi dhe rritja e transparencës brenda BE-së



Sipas rregullores, Shtetet Anëtare duhet të njoftojnë KE-në për çdo hetim të vazhdueshëm dhe ftohen të tregojnë nëse një investim i njoftuar rrezikon të ndikojë në sigurinë ose rendin publik të një Shteti Anëtar tjetër. Shteteve të tjera Anëtare u jepet mundësia të japin mendime dhe të deklarojnë nëse investimi në fjalë mund të ndikojë në sigurinë ose në rendin e tyre publik. Po ashtu, Komisioni mund të japë mendime të arsyetuara në rastet kur një investim kërcënon sigurinë ose rendin publik të më shumë se një Shteti Anëtar.

Për më tepër, Shtetet Anëtare dhe Komisioni mund të komentojnë mbi investimet e huaja të planifikuara ose të përfunduara në një Shtet tjetër Anëtar, por që nuk janë rishikuar (ende).³⁵ Deri më 31 mars të çdo viti, Shtetet Anëtare do t'i paraqesin Komisionit një raport vjetor për vitin e mëparshëm kalendarik, duke përfshirë përmbledhjen e informacioneve rreth IHD-ve që janë realizuar në territorin e tyre, bazuar në informacionin e disponueshëm për ta, si dhe informacion të përmbledhur rreth kërkesave të marra nga Shtetet e tjera Anëtare.³⁶

Bashkëpunimi për shqyrtimin e IHD-ve mes Shteteve Anëtare dhe Komisionit mbulon çdo investim të huaj të drejtpërdrejtë. Në të kundërt, investimet në portofol³⁷ janë jashtë sferës së veprimit të rregullores. Shtetet Anëtare të BE-së kanë qenë përgjithësisht pozitive karshi mekanizmit të BE-së për shqyrtimin e IHD-ve, pasi: (i) ka ndihmuar si shkas për vendosjen e regjimeve ndaj IHD-ve; (ii) ka ndihmuar Shtetet Anëtare të përshtatin qasjet e tyre për shqyrtimin e transaksioneve individuale; si dhe (iii) e bëri më të lehtë shpjegimin dhe mbrojtjen e një regjimi më të fuqishëm për shqyrtimin e IHD-ve.³⁸

3.2.7 Vendimi përfundimtar pas procesit të shqyrtimit



Vendimi përfundimtar nëse një investim i huaj që i nënshtrohet shqyrtimit është i autorizuar mbetet në dorë të Shtetit Anëtar ku bëhet investimi. Ndërsa Shtetet e tjera Anëtare ose Komisioni mund të ngrenë shqetësime, ata nuk mund të bllokojnë ose të zhbllokojnë investimin në fjalë. Kur një Shtet Anëtar merr komente nga Shtete të tjera Anëtare ose një mendim nga Komisioni, duhet t'i marrë parasysh këto komente ose mendime. Kjo mund të bëhet, nëse është e përshtatshme, me anë të masave të disponueshme sipas ligjit të tij kombëtar ose me hartimin politikave më të gjera, në përputhje me detyrimin për bashkëpunim të sinqertë.³⁹ Rregullorja nuk parashikon raste kur Shtetet Anëtare nuk marrin në konsideratë siç duhet komentet e Shteteve të tjera Anëtare ose mendimin e Komisionit, apo edhe nuk informojnë plotësisht Shtetet e tjera Anëtare që mund të preken nga IHD-të.

³⁵ Nenet 6 dhe 7.

³⁶ Neni 5.

³⁷ Gjykata e Drejtësisë e ka përshkruar "portofolin e investimeve" si "blerjen e aksioneve në tregun e kapitalit vetëm me qëllim kryerjen e një investimi financiar pa asnjë qëllim për të ndikuar në menaxhimin dhe kontrollin e sipërmarrjes". Shiko vendimin e datës 28 shtator 2006, Komisioni kundër Mbretërisë së Holandës, bashkimi i çështjeve C-282/04 dhe C-283/04, ECLI:EU:C:2006:608, paragraf. 19.

³⁸ "Shqyrtimi i investimeve të huaja: bashkëpunimi ndërkombëtar - arma sekrete për të mbrojtur më mirë interesat kombëtare?", Linklaters,

<https://www.linklaters.com/en/insights/blogs/foreigninvestmentlinks/2023/may/foreign-investment-screening-international-cooperation-protecting-national-interests>. Parë për herë të fundit më 30.05.2023.

³⁹ Pyetjet më të shpeshta për Rregulloren (BE) 2019/452 që përcakton një kuadër për shqyrtimin e investimeve të huaja direkte në BE, 21 qershor 2021.

<https://circabc.europa.eu/ui/group/be8b568f-73f3-409c-b4a4-30acfccec5283/library/7c76619a-2fcd-48a4-8138-63a813182df2/details>. Parë për herë të fundit më 12.06.2023.

3.2.8 Kompetencat e Komisionit për shqyrtimin e drejtpërdrejtë



Rregullorja, sipas nenit 8, i jep Komisionit kompetenca për të kontrolluar IHD-të që mund të ndikojnë në projekte ose programe me “interes të Bashkimit”, në veçanti projekte dhe programe që arrijnë në një vlerë të konsiderueshme ose një pjesë të konsiderueshme të fondeve të BE-së, apo të cilat mbulohen nga legjislacioni i BE-së në lidhje me infrastrukturën, teknologjitë ose lëndët e para kritike. Këto përfshijnë, ndër të tjera, Galileon, Kopernikun, Eurokontrollin dhe rrjetet evropiane të transmetimit të energjisë elektrike dhe gazit. Projektet ose programet me interes për Bashkimin janë përcaktuar në shtojcën e rregullores, të cilën Komisioni e ka përditësuar një herë, deri më tani.⁴⁰ Kur Komisioni konsideron se një investim ka të ngjarë të ndikojë në projekte ose programe me interes të Bashkimit për shkak të sigurisë ose rendit publik, Komisioni mund t'i japë një mendim Shtetit ose Shteteve Anëtare përkatëse, duke e përcjellë për dijeni tek Shtetet e tjera Anëtare. Shtetet Anëtare duhet të tregojnë “konsideratat maksimale” për këto mendime dhe të japin shpjegime për çdo rast mospërputhje. Komisioni nuk ka kompetencë për të ndaluar ose vendosur kushte për një transaksion, megjithatë, çdo veprim i rekomanduar nga Komisioni duhet të zbatohet sipas ligjeve të Shteteve Anëtare.

3.2.9 Rishikimet e mëtejshme



Deri më 12 tetor 2023 dhe më pas çdo pesë vjet, Komisioni duhet të vlerësojë funksionimin dhe efektivitetin e kësaj rregulloreje dhe t'i paraqesë një raport Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian. Raporti duhet të përfshijë një vlerësim nëse kjo rregullore duhet të ndryshohet apo jo. Raporti, kur propozon ndryshimin e kësaj rregulloreje, mund të shoqërohet me propozime ligjore.

3.3. Mekanizmat e shqyrtimit të Shteteve Anëtare: të dhëna dhe zhvillime

Sipas rregullores, Shtetet Anëtare mund të mbajnë mekanizmat e tyre ekzistuese të shqyrtimit, të miratojnë të reja, ose të mbeten pa mekanizma të tillë kombëtarë. Komisioni iu bën thirrje Shteteve Anëtare që aktualisht nuk kanë një mekanizëm shqyrtimi, ose mekanizmat e shqyrtimit të cilave nuk mbulojnë të gjitha transaksionet përkatëse të IHD-ve, apo që nuk lejojnë shqyrtimin para se të bëhen investimet, të krijojnë urgjentisht një mekanizëm gjithëpërfshirës për shqyrtimin e IHD-ve. Ndërkohë, ai iu bën thirrje Shteteve Anëtare të përdorin instrumente të tjera ligjore të përshtatshme për të trajtuar ato raste kur blerja ose kontrolli i një biznesi, infrastrukture apo teknologjie të veçantë do të krijonte rrezik për sigurinë ose rendin publik të BE-së.

Komisioni publikon listën e mekanizmave të shqyrtimit të njoftuar nga Shtetet Anëtare në nivel BE-je.⁴¹ Bazuar në këto njoftime,⁴² deri më 2 shkurt 2023, rezultoi se kanë një mekanizëm shqyrtimi 18 Shtetet Anëtare të mëposhtme: Austria, Republika Çeke, Danimarka, Finlanda, Franca, Gjermania, Hungaria, Italia, Letonia, Lituania, Malta, Holanda, Polonia, Portugalia, Rumania, Sllovakia, Sllovenia dhe Spanja.

Rregullorja kërkon që Komisioni t'i paraqesë Parlamentit dhe Këshillit një raport për zbatimin e rregullores në bazë vjetore. Aktualisht, KE-ja ka publikuar raportin e saj të dytë për Shqyrtimin e

⁴⁰<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32021R2126>. Parë për herë të fundit më 12.06.2023.

⁴¹ https://policy.trade.ec.europa.eu/enforcement-and-protection/investment-screening_en. Parë për herë të fundit më 12.06.2023.

⁴² Sipas nenit 3.7 të Rregullores, Shtetet Anëtare do të njoftojnë Komisionin për mekanizmat e tyre ekzistues të shqyrtimit deri më 10 maj 2019. Shtetet Anëtare do të njoftojnë Komisionin për çdo mekanizëm shqyrtimi të miratuar rishtazi ose për çdo ndryshim të një mekanizmi ekzistues shqyrtimi brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e mekanizmit të sapo miratuar të shqyrtimit ose për çdo ndryshim të një mekanizmi ekzistues shqyrtimi.

Investimeve të Huaja Direkte, të miratuar më 1 shtator 2022, me të dhëna dhe informacione përkatëse rreth zhvillimeve të shqyrtimit të IHD-ve në Shtetet Anëtare të BE-së përgjatë vitit 2021.⁴³

Sipas këtyre të dhënave zyrtare, 25 nga 27 Shtete Anëtare: (i) kishin një mekanizëm kombëtar për shqyrtimin e IHD-ve; ose (ii) kishin miratuar një mekanizëm të ri kombëtar për shqyrtimin e IHD-ve; ose (iii) kishin ndryshuar mekanizmin ekzistues; ose (iv) kishin nisur një proces konsultativ ose legjislativ që pritet të rezultojë me miratimin e një mekanizmi të ri ose ndryshimin e një mekanizmi ekzistues. Tabela 2 paraqet një pasqyrë të situatës ligjore dhe zhvillimeve në 27 Shtete Anëtare, në vitin 2021.

Tabela 2 - Zhvillimet ligjore të Shteteve Anëtare të BE-së në lidhje me MSHI-të

Kanë një mekanizëm kombëtar për shqyrtimin e IHD-ve në zbatim	AUSTRI, FINLANDË, MALTË, POLONI, PORTUGALI, SLLOVENI, SPANJË
Kanë ndryshuar mekanizmin ekzistues	FRANCË, GJERMANI, HUNGARI, ITALI, LETONI, LITUANI
Kanë nisur një proces konsultativ ose legjislativ që pritet të rezultojë në ndryshimin e një mekanizmi ekzistues	HOLANDË, RUMANI
Kanë miratuar një mekanizëm të ri kombëtar për shqyrtimin e IHD-ve	ÇEKI, DANIMARKË, SLLOVAKI
Kanë nisur një proces konsultativ ose legjislativ që pritet të rezultojë në miratimin e një mekanizmi të ri	BELGIKË, KROACI, ESTONI, GREQI, IRLANDË, LUKSEMBURG, SUEDI
Nuk kanë njoftuar publikisht ndërmarrjen e nismës	BULLGARI, QIPRO

Burimi: KE

Shumica e ndryshimeve në legjislacionin kombëtar trajtonin tre tema: përmirësimin e procedurave të shqyrtimit, zgjerimin e sektorëve të mbuluar dhe zgjatjen e vlefshmërisë së mekanizmave kombëtarë.

KUTIA 2

Shembuj të zhvillimeve ligjore për MSHI-të në disa vende të BE-së

Franca uli pragun në të cilin shqyrtohen imtësisht investimet nga investitorë jo evropianë. Rregullorja e re ul pragjet që bëhen shkas për rishikimin e detyrueshëm të investimeve, nga 33.33% në 25%. Për më tepër, ajo zgjeron sferën e veprimit sektorial të mekanizmit duke shtuar sektorët e shtypit të shkruar dhe mediat dixhitale, sigurinë ushqimore dhe teknologjitë kritike (si p.sh., sigurinë kibernetike, inteligjencën artificiale, robotikën, prodhimin e aditivëve, gjysmëpërçuesit, teknologjitë kuantike dhe ruajtja e energjisë).

Gjermania paraqiti një sërë ndryshimesh procedurale (p.sh. shtimi i 16 grupeve të reja të çështjeve që lidhen me teknologjitë në zhvillim/të ndjeshme); aplikoi pragje të reja për


⁴³ [https://ec.europa.eu/transparency/documents-register/detail?ref=COM\(2022\)433&lang=en](https://ec.europa.eu/transparency/documents-register/detail?ref=COM(2022)433&lang=en). Parë për herë të fundit më 12.06.2023. Raporti i tretë vjetor për shqyrtimin e IHD-ve në BE që mbulon vitin 2022 pritet të publikohet deri në shtator 2023.

blerjen e kapitalit dhe të drejtat e votës që kërkojnë një njoftim; si dhe paraqiti kërkesa të reja për investitorët.

Italia zgjeroi zbatueshmërinë e mekanizmit të saj ekzistues të shqyrtimit⁴⁴ dhe më vonë në shtator 2022 ndryshoi rregulloret “fuqia e artë” duke paraqitur një numër masash për të koordinuar dhe rregulluar më mirë aktivitetet e departamenteve të qeverisë italiane përgjegjëse për shqyrtimin e transaksioneve, si dhe një procedurë të shumë të pritur për para njoftimin vullnetar.⁴⁵

Në **Hollandë**,⁴⁶ rregullat e përgjithshme të shqyrtimit të investimeve/kontrollit të IHD-ve të miratuara në vitin 2022 hynë në fuqi më 1 qershor 2023. Kjo nuk do të thotë vetëm që investimet e ardhshme, kualifikuese, në infrastrukturë kritike apo teknologjitë e ndjeshme do të duhet t'i njoftohen ministrit holandez për Çështjet Ekonomike, por edhe që ministri mund t'u kërkojë palëve të paraqesin një njoftim brenda tetë muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, nëse një investim i bërë pas datës 8 shtator 2020 mund të përbëjë rrezik për sigurinë kombëtare.

Grafiku 2 - Aktivitetet e Shteteve Anëtare në lidhje me shqyrtimin e IHD-ve



Burimi: KE

Në përfundim, vlen të përmendet se sipas Komisionit, Shtetet Anëtare bllokuan vetëm 1% të transaksioneve (krahasuar me disi më shumë në raportin e parë, d.m.th. 2%), duke konfirmuar se BE-ja mbetet e hapur ndaj IHD-ve dhe Shtetet Anëtare nuk aprovojnë vetëm ato raste që paraqesin kërcënime tejet serioze për sigurinë dhe rendin publik. Ndërsa bllokimi i IHD-ve mbetet një rast përjashtimor në shumicën e Shteteve Anëtare, në juridiksione të tjera, disa investitorë mund të zgjedhin të braktisin transaksionet e tyre, në vend që të lejojnë që autoritetet t'i bllokojnë ato. Raporti vjetor i BE-së zbuloi se 3% e transaksioneve ishin tërhequr. Sipas raportit, 23% e vendimeve përfshinin një miratim me kushte ose masa lehtësuese.

MSHI-të e miratuara nga 18 shtete anëtare parashikojnë një larmi karakteristikash dhe qasjesh ndaj IHD-ve. Shumëllojshmëria e mekanizmave të shqyrtimit të miratuara nga Shtetet Anëtare

⁴⁴ [https://ec.europa.eu/transparency/documents-register/detail?ref=COM\(2022\)433&lang=en](https://ec.europa.eu/transparency/documents-register/detail?ref=COM(2022)433&lang=en). Parë për herë të fundit më 12.06.2023.

⁴⁵ <https://www.cliffordchance.com/insights/resources/blogs/antitrust-IHD-insights/2022/09/recent-amendments-to-the-italian-golden-power-regime-the-pre-notification-procedure.html> Parë për herë të fundit më 30.05.2023.

⁴⁶ Holanda ka prezantuar dy mekanizma të shqyrtimit të IHD-ve: Mekanizmi i përgjithshëm i shqyrtimit të IHD-ve dhe ligji për telekomunikacionin me ndikim të papërshtatshëm. Mekanizmi i përgjithshëm i shqyrtimit të IHD-ve hyn në fuqi më 1 qershor 2023 dhe është pjesërisht retroaktiv nga 8 shtatori 2020. Ligji për telekomunikacionin me ndikim të papërshtatshëm tashmë ka hyrë në fuqi në tetor 2020.

evidentohet *ndër të tjera* në sa vijon: (i) nëse parashikojnë paraqitjen e detyrueshme ose vullnetare të kërkesës, ose të drejtën e ndërhyrjes kryesisht nga ana e qeverisë; (ii) se cilat industri shihen si “kritike” dhe si rrjedhim mund të shkaktojnë një detyrim për paraqitjen e kërkesës dhe/ose ndërhyrjen nga ana e qeverisë; (iii) kur ekzistojnë kërkesa për paraqitjen e kërkesës, nëse ekziston një prag që lidhet me përqindjen e të drejtave të votës ose aksioneve të blera; (iv) nëse qeveria ka të drejtë të ndërhyjë nën pragun; (v) kohëzgjatja dhe struktura e procedimit, etj. Kjo është kryesisht për shkak të faktit se Rregullorja 2019/452 përcaktoi vetëm premiset dhe kuadrin e përgjithshëm të MSHI-ve, së bashku me mekanizmin e bashkëpunimit në nivel BE-je, dhe jo një qasje të detyrueshme për tu zbatuar nga ana e shteteve anëtare.

3.4. Shembuj të kërkesave për shqyrtimin e IHD-ve

KUTIA 3

Porti i Hamburgut, Gjermani

Një shembull i kohëve të fundit i shqyrtimit të IHD-ve në Gjermani ka të bëjë me ndalimin e pjesëm të investimit të propozuar nga shoqëria shtetërore kineze “COSCO Shipping Group” në një terminal kontejnerësh në Portin e Hamburgut. Ndërsa investimi fillimisht ishte 35%, Kancelarja gjermane autorizoi vetëm blerjen e një pjese nën 25%, e cila përfaqëson një pakicë aksionesh të operatorit të një terminali kontejnerësh, mbi bazën e shqetësimeve se një blerje e një pjese më të madhe aksionesh mund të përbëjë një rrezik për sigurinë kombëtare. Qeveria tha se do t'i përmbahej një kompromisi të rëndë dakord në vitin e kaluar që ndalon COSCO Shipping të blejë më shumë se 24,99% të terminalit Tollerort të shoqërisë së logjistikës portuale të Hamburgut, HHLA. COSCO gjithashtu zotëron aksione në disa porte të tjera evropiane, duke përfshirë portin kryesor të Greqisë, Pireun.⁴⁷

KUTIA 4

Transferimi i teknologjisë, Itali

Kryeministri i Italisë vendosi veton ndaj një transferimi të teknologjisë dhe softuerit në Kinë në një marrëveshje që përfshinte përpjekjet e prodhuesit industrial të robotëve EFORT Intelligent Equipment për të rritur aksionet e tij nga 40% në 49% në firmën italiane ROBOX. Ky i fundit projekton dhe prodhon komponentë elektronikë për robotikën dhe sistemet e kontrollit të lëvizjes. Përveç rritjes së aksioneve në pronësi me vlerë 2 milionë euro (2,14 milionë dollarë), marrëveshja parashikonte që ROBOX-i të autorizonte EFORT-in të përdorte disa nga kodet e saj burimore. Italia rezervon të drejtën të përdorë legjislacionin e saj “fuqitë e arta” kundër marrjes nën kontroll për të përjashtuar oferta të padëshiruara në industri që konsiderohen me rëndësi strategjike, të tilla si bankat, energjia, telekomunikacioni dhe shëndetësia. Siç raportohet në media, me çështjen ROBOX, bëhet hera e shtatë që Roma ndalon interesat e huaja në Itali që nga prezantimi i legjislacionit “fuqitë e arta” në vitin 2012. Gjashtë nga këto raste kishin të bënin me oferta kineze.⁴⁸

⁴⁷AP News, më 23 maj 2023,

<https://apnews.com/article/germany-china-hamburg-port-investment-cosco-0036bf44045321f3a2a35b1c941ef6a9>. Parë për herë të fundit më 30.05.2023

⁴⁸Reuters News, më 7 qershor 2022.

<https://www.reuters.com/technology/italys-pm-draghi-vetoes-technology-transfer-china-2022-06-07/>. Parë për herë të fundit më 30.05.2023.

3.5. Çfarë të presim më pas?

Siç u tha më lart, rregullorja i nënshtrohet një vlerësimi nga KE-ja deri më 12 tetor 2023, pas së cilës do të paraqitet një raport para Parlamentit dhe Këshillit të BE-së. Disa analiza dhe raporte tashmë ofrojnë sugjerime për përmirësimin e rregullores. Në një raport të publikuar në vitin 2022, OECD-ja bën një vlerësim të plotë të efektivitetit dhe efikasitetit të MSHI-ve në nivel BE-je.⁴⁹ Raporti identifikoi disa çështje kyç, ndër të cilat mund të përmendim:

- 1 Mungesa e shqyrtimit tek disa Shtete Anëtare. Shtetet Anëtare që nuk kanë mekanizëm shqyrtimi kanë pak ose aspak mjete efektive për të menaxhuar rrezikun e investimeve të huaja, nuk ndërtojnë kapacitete institucionale dhe nuk mund të përfitojnë plotësisht nga shkëmbimet e informacionit me homologët e tyre nga Shtetet e tjera Anëtare dhe KE-ja.
- 2 Sfera e veprimtarisë sektoriale e mekanizmave të shqyrtimit të Shteteve Anëtare përcaktohet shumë ndryshe. Vetëm disa Shtete Anëtare mund të shqyrtojnë transaksionet në çdo sektor të ekonomisë së tyre, ndërsa të tjerët veprojnë në bazë të listave të sektorëve ose aktiveve të individualizuara.
- 3 Jo të gjitha Shtetet Anëtare kanë kompetenca të qarta për të vepruar ndaj komenteve të marra nga Shtetet e tjera Anëtare. Nuk ka asnjë mekanizëm llogaridhënie që të kërkojë që një Shtet Anëtar të ndihmojë një tjetër për të parandaluar rezultatet negative të sigurisë ose rendin publik përtej detyrës së bashkëpunimit të sinqertë.
- 4 Afatet kohore për shqyrtimin e vendimeve në disa Shtete Anëtare janë shumë të shkurtra për të përfshirë në mënyrë efektive kontributin nga mekanizmi i bashkëpunimit. Këto mund të kalojnë para se të mbërrijnë komentet, opinionet dhe informacionet e tjera të dhëna sipas mekanizmave të bashkëpunimit.

Në përputhje me nenin 12, KE-ja asistohet nga një grup ekspertësh për shqyrtimin e IHD-ve në Bashkimin Evropian, të cilët i ofrojnë Komisionit këshilla dhe ekspertizë. Mbi bazën e kësaj premise, ata vazhdojnë të diskutojnë çështje që kanë të bëjnë me shqyrtimin e IHD-ve, të ndajnë praktikat më të mira dhe mësimet e nxjerra, si dhe të shkëmbejnë pikëpamje mbi tendencat dhe çështjet me interes të përbashkët në lidhje me IHD-të. KE-ja duhet të ketë parasysh që edhe të kërkojë këshillën e këtij grupi për çështje sistematike që lidhen me zbatimin e kësaj rregulloreje. Diskutimet e këtij grupi, sipas rregullores, mbahen konfidenciale.

Është e sigurt që në fazën aktuale KE-ja po monitoron zbatimin e Rregullores si dhe shqetësimet e ngritura në raporte nga ekspertët, academia, investitorët dhe institucionet e Shteteve Anëtare, si dhe nga jurisprudenca në nivel BE-je. Niveli i reagimit të KE-së në muajt e ardhshëm lidhur me rregulloren nuk mund të parashikohet. Sidoqoftë, duket se për shumë çështje, po konsolidohet një qasje e unifikuar mes ekspertëve për nevojën e një qasjeje më të unifikuar për zbatimin e MSHI-ve dhe veprimeve përkatëse të korrigjimit përmes përmirësimeve të rregullores aktuale. Niveli i këtyre përmirësimeve mund të ndryshojë gjithashtu paradigmen aktuale të MSHI-ve në nivel BE-je.

Në nivelin e Shteteve Anëtare, siç u theksua më lart, miratimi i rregullores që lidhet me thirrjen e Komisionit, tendencat gjeopolitike dhe sfidat që lindën nga pandemia COVID-19 kanë bërë që

⁴⁹ OECD 2022, Kuadri për shqyrtimin e investimeve të huaja direkte në BE. <https://www.oecd.org/investment/investment-policy/oecd-eu-IHD-screening-assessment.pdf>. Parë për herë të fundit më 12.06.2023.

shumë shtete të përqafojnë ose zgjerojnë ndjeshëm mekanizmat e shqyrtimit të IHD-ve. Shembujt më në zë përfshijnë Estoninë dhe Sllovakinë.

KUTIA 5

Zgjerimi i mekanizmave të shqyrtimit të IHD-ve në më shumë juridiksione

Estonia

Megjithëse gjatë diskutimeve paraprake për hartimin e rregullores ishte një nga vendet me qëndrim të kundërt, Estonia kohët e fundit ajo ka ndryshuar qasjen e saj. Më 25 janar 2023, Parlamenti Estonez miratoi ligjin për vlerësimin e besueshmërisë së investimeve të huaja (Välisinvesteeringu usaldusväärtsuse hindamise seadus), i cili prezantoi një regjim shqyrtimi të IHD-ve. Legjislacioni i ri zbatohet për investimet e huaja me origjinë jo nga BE-ja në fusha strategjike dhe të ndjeshme që kanë rëndësi për funksionimin e shtetit (si energjia, transporti, komunikimet, etj.) ose për shoqëri specifike, për shembull, ofruesit e shërbimeve jetike, ndërmarrjet publike, shoqëritë e mediave, menaxherët e rezervave shtetërore operuese, si dhe operatorët e infrastrukturës së transportit. Ligji hyri në fuqi në 1 Shtator 2023.⁵⁰

Sllovakia

Për sa i takon Sllovakisë, ajo ishte një shtet neutral gjatë diskutimit të miratimit të një mekanizmi shqyrtimi pan-evropian. Këshilli Kombëtar i saj miratoi më 29 nëntor 2022, ligjin nr. 497/2022 Kol. për shqyrtimin e investimeve të huaja direkte për mbrojtjen e sigurisë dhe rendit publik. Ai përcakton për herë të parë një legjislacion të plotë për investimet e huaja direkte dhe zgjeron ndjeshëm fushën e veprimit të regjimit të shqyrtimit të IHD-ve. Ky legjislacion hyri në fuqi më 1 mars 2023.⁵¹

Një prirje e dukshme është shfaqur brenda Shteteve Anëtare të BE-së, e karakterizuar nga paraqitja e regjimeve të reja për shqyrtimin e IHD-ve ose zgjerimin e konsiderueshëm të regjimeve ekzistues. Ky zhvillim vendos një theks në rritje për mbrojtjen e sektorëve strategjikë dhe pasurive kritike nga rreziqet e mundshme që lidhen me investimet e huaja.

3.6. Regjimet e shqyrtimit të IHD-ve dhe vendet e Ballkanit Perëndimor

Në kontekstin e procesit të integritimit në Bashkimin Evropian, vendet e Ballkanit Perëndimor (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia) paraqesin një aspekt intrigues që ia vlen të merret në shqyrtim: paradigma në zhvillim e regjimeve të shqyrtimit të IHD-ve.

Janë duke u zhvilluar bisedime për procesin e anëtarësimit me Malin e Zi dhe Serbinë. Që nga viti 2020, Këshilli ra dakord të hapë negociatat e anëtarësimit me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë. Bosnja dhe Hercegovina dhe Kosova janë kandidatë të mundshme për anëtarësimin në BE.⁵² Të gjithë partnerët e Ballkanit Perëndimor kanë Marrëveshje Stabilizimi dhe Asociimi me BE-në, duke e përafëruar rajonin me standardet e BE-së.⁵³

⁵⁰UNCTAD, "Estonia: Prezantoni një regjim për shqyrtimin e IHD-ve", 25 janar 2023".

<https://investmentpolicy.unctad.org/investment-policy-monitor/measure/4207/introduces-an-IHD-screening-regime>. Parë për herë të fundit më 12.06.2023.

⁵¹UNCTAD, "Sllovakia: Zgjeron regjimin e saj për shqyrtimin e IHD-ve", 29 nëntor 2022".


<https://investmentpolicy.unctad.org/investment-policy-monitor/measure/4172/expands-its-IHD-screening-regime>. Parë për herë të fundit më 12.06.2023.

⁵² https://www.eeas.europa.eu/eeas/western-balkans_en#9519; Parë për herë të fundit më 12.06.2023.

⁵³Ibid.


Ndërsa këto shtete përpiqen të përafrojnë kornizat e tyre ekonomike dhe rregullatore me standardet e BE, lind pyetja si do të lundrojnë në lëmin kompleks të investimeve të huaja dhe rreziqeve të mundshme. Ndërsa Ballkani Perëndimor ka qenë tradicionalisht destinacion tërheqës për IHD-të për shkak të vendndodhjes strategjike dhe potencialit ekonomik, siç tregohet nga grafikët 3 dhe 4, deri më tani asnjë nga vendet e Ballkanit Perëndimor nuk ka miratuar një mekanizëm shqyrtimi të IHD-ve.⁵⁴

Grafiku 3- Fluksi hyrës i IHD-ve në vendet e Ballkanit Perëndimor, në milionë dollarë



Burimi: Këshilli Shqiptar i Investimeve, 2023⁵⁵

Grafiku 4 - Fluksi hyrës i IHD-ve si % e PBB-së në vendet e Ballkanit Perëndimor



Burimi: Këshilli Shqiptar i Investimeve, 2023

Dinamika e ndryshueshme rreth shqyrtimit të IHD-ve në BE kërkon një shqyrtim të kujdesshëm të mënyrës se si këto vende do të trajtojnë shqetësimet që lidhen me sigurinë kombëtare dhe rendin publik.

⁵⁴Qendra për Nismën Qytetare, "Mekanizmi i shqyrtimit të investimeve të huaja direkte: një perspektivë për Bosnjen dhe Hercegovinën", 2022.

⁵⁵Sekretariati i Këshillit të Investimeve të Shqipërisë, "Një pasqyrë e treguesve të zhvillimit ekonomik të Shqipërisë", 2023, (https://www.investment.com.al/wp-content/uploads/2023/05/EN_Albania-Economic-Outlook-2022.pdf); Parë për herë të fundit më 12.06.2023.

Ndërsa rajoni përparon në aspektin e anëtarësimit në BE, bëhet e domosdoshme të vlerësohet shkalla në të cilën do të miratohen ose përmirësohen mekanizmat e shqyrtimit të IHD-ve, duke siguruar përafrimin e kornizave të tyre të investimeve me normat dhe praktikën në zhvillim të Bashkimit Evropian.

Deri më sot, janë zhvilluar diskutime të rëndësishme në lidhje me shtete të ndryshme të Ballkanit Perëndimor, por ka munguar një vlerësim gjithëpërfshirës i dedikuar posaçërisht për Shqipërinë. Ky vlerësim sistematik kërkon një analizë gjithëpërfshirëse të treguesve ekonomikë që lidhen me IHD-të dhe kuadrin ligjor e rregullator ekzistues për investimet, duke siguruar një kuptim tërësor të kontekstit dhe udhëhequr rrugën më efektive përpara.

IV. IHD-TË NË SHQIPËRI


4.1. IHD-të si kontribuuese në ekonominë shqiptare: fluksi, stoku dhe origjina

IHD-të janë shfaqur si një komponent jetik dhe në zgjerim të vazhdueshëm të ekonomisë shqiptare, duke luajtur një rol kryesor në rritjen dhe zhvillimin e saj. Gjatë këtyre viteve, Shqipëria ka qenë dëshmitare e një fluksi të konsiderueshëm të kapitalit të huaj, teknologjive dhe ekspertizës përmes hyrjes së IHD-ve.

4.1.1. Fluksi i IHD-ve

Bazuar në të dhënat zyrtare të Bankës së Shqipërisë, fluksi IHD-ve që ka hyrë në Shqipëri arriti nivele të paprecedentë në vitin 2022, duke përfaqësuar statistikat më të fundit të vitit të plotë në dispozicion. Fluksi i regjistruar i IHD-ve për vitin 2022 arriti në 1,372 miliardë euro, duke treguar një normë të konsiderueshme rritjeje me rreth 32,5% në krahasim me vitin e kaluar. Fitimet e riinvestuara përbënin 53% të këtij fluksi, duke treguar një prirje të vazhdueshme rritëse.⁵⁶ Ndërsa ka pasur rënie të lehta të fluksit të IHD-ve në vitet 2017 dhe 2020, siç tregohet në grafikun 5 më poshtë, trajektorja e përgjithshme tregon një rritje të qëndrueshme që nga fillimi i të dhënave të regjistruara. IHD-të në Shqipëri janë rikthyer fuqishëm dhe janë rritur në nivel rekordi historik, duke theksuar kështu tërheqjen e vendit për investitorët e huaj.

Grafiku 5 – Fluksi hyrës i IHD-ve në Shqipëri për periudhën 2015-2022, në milionë euro



Burimi: Banka e Shqipërisë, 2023


Kjo tendencë rritje e qëndrueshme vijoi edhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2023. Shuma e IHD-ve të regjistruara ishte 308 milionë euro, duke shënuar një rritje prej 1,65% krahasuar me

⁵⁶ Sekretariati i Këshillit të Investimeve të Shqipërisë, "Një pasqyrë e treguesve të zhvillimit ekonomik të Shqipërisë (2022)", 2023, (https://www.investment.com.al/wp-content/uploads/2023/05/EN_Albania-Economic-Outlook-2022.pdf); Parë për herë të fundit më 12.06.2023.

periudhën përkatëse të vitit të kaluar. Kjo shënon një nivel të ri të lartë për këtë periudhë. Përbërja e këtyre investimeve tregon se fitimet e riinvestuara përbënin komponentin mbizotërues, megjithëse fluksi i IHD-ve të reja gjithashtu dëshmoi një rritje të konsiderueshme.⁵⁷


IHD-të luajnë një rol kryesor në kontributin e tyre në prodhimin e brendshëm bruto (PBB) të Shqipërisë, siç tregohet në grafikun 6, duke tejkaluar shpesh ndikimin e investimeve publike (siç tregohet në grafikun 7 më poshtë).

Grafiku 6 – Fluksi hyrës i IHD-ve në Shqipëri si % e PBB-së për periudhën 2015-2022, në milionë euro



Burimi: Banka e Shqipërisë, Këshilli Shqiptar i Investimeve⁵⁸

Grafiku 7 - IHD-të si % e PBB-së së Shqipërisë krahasuar investimet publike si % e PBB-së



Burimi: Këshilli Shqiptar i Investimeve, 2023


⁵⁷ <https://www.monitor.al/investimet-e-huaja-direkte-arriten-rekord-te-ri-ne-tremujorin-e-pare-te-vitit/>; Parë për herë të fundit më 12.06.2023; Sekretariati i Këshillit Shqiptar të Investimeve, "Një pasqyrë e treguesve të zhvillimit ekonomik të Shqipërisë (të dhënat e disponueshme janar – qershor 2023)", 2023, (https://www.investment.com.al/wp-content/uploads/2023/07/EN_Albania-Economic-Outlook-2023-H1.pdf) ; Parë për herë të fundit më 31.08.2023.

⁵⁸ Sekretariati i Këshillit të Investimeve të Shqipërisë, "Një pasqyrë e treguesve të zhvillimit ekonomik të Shqipërisë (2022)", 2023, (https://www.investment.com.al/wp-content/uploads/2023/05/EN_Albania-Economic-Outlook-2022.pdf); Parë për herë të fundit më 12.06.2023.

Në vitin 2022, sektori i aktiviteteve të pasurive të paluajtshme doli si marrësi kryesor i hyrjeve të IHD-ve, duke zënë afërsisht 21,1% të shumës gjithsej.⁵⁹ Kjo paraqet një ndryshim të dukshëm në tendencën e fundit, pasi sektori i energjisë kishte qenë sektori dominues për flukset hyrëse të IHD-ve që nga viti 2018.⁶⁰

Përveç pasurive të paluajtshme, sektorë të tjerë që patën prurje të konsiderueshme të IHD-ve në vitin 2022 përfshinin industrinë nxjerrëse (19,5%), energjinë (12,7%) dhe prodhimin (10,6%), siç tregohet në grafikun 8.

Grafiku 8 – Fluksi hyrës i IHD-ve për sektor në Shqipëri për vitin 2022



Burimi: Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, 2023

Për sa i përket tremujorit të parë të vitit 2023, tendenca duket se ka ndryshuar dhe sektori kryesor që ka marrë IHD në Shqipëri ka qenë industria nxjerrëse me rreth 21%, kryesisht e lidhur me industrinë e naftës.⁶¹

Për sa i përket stokut të IHD-ve, siç tregohet në grafikun 9 më poshtë, sektori i furnizimit me energji elektrike dhe gaz përbën burimin më të madh, duke përbërë 26,5% të stokut të përgjithshëm. Sektorë të tjerë që japin kontribut të konsiderueshëm në stokun e IHD-ve përfshijnë industrinë nxjerrëse (15,3%), aktivitetet financiare dhe të sigurimit (12%), informacionin dhe komunikimin (10,6%) dhe aktivitetet e lidhura me pasuritë e paluajtshme (10%).⁶²


⁵⁹Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, Investimet e Huaja Direkte (<https://www.aida.gov.al/sq/biznes-ne-shqiperi/investime-te-huaja-direkte>); Sekretariati i Këshillit të Investimeve të Shqipërisë, "Një pasqyrë e treguesve të zhvillimit ekonomik të Shqipërisë (2022)", prill 2023.

⁶⁰ Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, "Broshura Investo në Shqipëri 2022", 2022. (<https://www.aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/publikime/1235-booklet-invest-in-albania-2022>) Parë për herë të fundit më 12.06.2023.

⁶¹ Shiko ref. 57.

⁶² Shiko ref. 60.

Grafiku 9 – Stoku i IHD-ve për sektor ekonomik në Shqipëri për vitin 2022




Burimi: Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, 2023

Këto shifra nxjerrin në pah sektorët e ndryshëm që tërheqin investimet e huaja, duke reflektuar kuadrin në zhvillim të ekonomisë shqiptare.

4.1.2. Stoku i IHD-ve

Treguesi për stokun e IHD-ve në Shqipëri arriti një rekord të lartë prej 11 399 milion euro në vitin 2022, duke përfaqësuar një rritje të dukshme prej rreth 18,8% krahasuar me një vit më parë. Grafiku 10 më poshtë paraqet vlerat e stokut të IHD-ve të regjistruara nga Banka e Shqipërisë që nga viti 2015 deri në vitin e fundit të plotë për të cilin disponohen të dhëna.

Grafiku 10 – Stoku i IHD-ve në Shqipëri për periudhën 2015-2022, në milionë euro




Burimi: Banka e Shqipërisë

Trendi i rritjes së stokut të IHD-ve vazhdoi edhe përgjatë tremujorit të parë të vitit 2023, duke shënuar një rritje të konsiderueshme prej 19,6% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Raporti i stokut të IHD-ve ndaj PBB-së, siç tregohet në grafikun 11, tregon se IHD-të kanë luajtur gjithmonë një rol të rëndësishëm në ekonominë e vendit.

Grafiku 11 – Raporti i stokut të IHD-ve ndaj PBB-së së Shqipërisë për periudhën 2015-2022




Burimi: Këshilli Shqiptar i Investimeve, bazuar në të dhënat e INSTAT, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Banka e Shqipërisë

4.1.3. Vendi i origjinës së IHD-ve

Holanda rezultoi të jetë vendi kryesor i burimit të flukseve hyrëse të IHD-ve në Shqipëri, duke kontribuar afërsisht me 218 milionë euro ose 15,88% të flukseve hyrëse gjithsej në vitin 2022. Kjo tendencë ndjek një model të ngjashëm të vërejtur në vitin 2021, ku Holanda mbante gjithashtu pjesën më të madhe të hyrjeve të IHD-ve, duke zënë rreth 23% të shumës së përgjithshme të IHD-ve. Megjithatë, në tremujorin e parë të vitit 2023, të dhënat e Bankës së Shqipërisë tregojnë një zhvendosje të vogël të kësaj tendence. Ndërsa mbetet ende me ndikim të madh, Holanda me sa duket nuk është më vendi nga i cili buron pjesa më e madhe e flukseve hyrëse të IHD-ve, por përkundrazi ia ka lënë kryesimin vendeve të tjera, të cilat BSH-ja i mban konfidenciale.

Përveç Holandës, vendet e tjera burimore të rëndësishme të IHD-ve në vitin 2022, siç tregohet në grafikun 12, përfshijnë Italinë, e cila ka kontribuar afro 135,42 milionë euro ose 9,8%, Gjermaninë me rreth 91,28 milionë euro ose 6,65%, Austrinë me 82,44 milionë euro ose 6% dhe Turqinë me 56,63 milionë euro ose 4,10%.

Grafiku 12 – Pesë vendet kontribuuese kryesore të hyrjeve të IHD-ve në Shqipëri në vitin 2022, në milionë euro




Burimi: Banka e Shqipërisë

Analiza e origjinës së stokut të IHD-ve në Shqipëri zbulon se vendet kryesore të origjinës janë Zvicra, Holanda, Kanadaja, Italia dhe Turqia, siç paraqitet në grafikun 13 më poshtë. Stoku i konsiderueshëm i IHD-ve nga Zvicra ka të ngjarë të jetë si pasojë e investimit në Gazsjellësin Trans Adriatik (TAP), një sipërmarrje e përbashkët që përfshin shoqëritë si Socar, BP, Snam, Fluxys, Enagas. Ndërsa shoqëria TAP është e regjistruar në Zvicër, ajo përfaqëson interesat e shoqërive që operojnë në shumë shtete.

Në mënyrë të ngjashme, stoku i konsiderueshëm i IHD-ve me origjinë nga Kanadaja ka të ngjarë të jetë i lidhur me Bankers, prodhuesin më të madh të naftës në Shqipëri. Vlen të theksohet se Bankers ka pasur kontrollin përfundimtar të shoqërive kineze që nga viti 2016, megjithëse ka lidhje historike me Kanadanë. Të dhënat e stokut të IHD-ve tregojnë gamën e larmishme të vendeve që kontribuojnë në kuadrin e investimeve në Shqipëri, duke pasqyruar si bashkëpunimet shumëkombëshe, ashtu edhe interesat strategjike të shteteve të ndryshme në ekonominë e vendit. Për më tepër, kjo gjë mund të nxjerrë në pah domosdoshmërinë e diversifikimit të metodologjisë së BSH-së për regjistrimin e vendeve të origjinës së IHD-ve duke përfshirë edhe kontrollin përfundimtar në të dhënat e saj të regjistruara.

Grafiku 13 – 5 vendet e origjinës së stokut të IHD-ve që renditen të parat në Shqipëri (si % e totalit të stokut)



Burimi: Banka e Shqipërisë, 2023

4.2. Kuadri ligjor dhe rregullator

4.2.1. Nga një ekonomi e centralizuar në një regjim të hapur

Regjimi Shqipërisë për tregtinë me jashtë është liberalizuar që nga viti 1990 dhe është në përputhje me udhëzimet e përcaktuara nga BE-ja dhe Organizata Botërore e Tregtisë (OBT).

Që nga hapja e tregut të saj për investitorët e huaj për herë të parë 30 vjet më parë, rritja ekonomike e Shqipërisë është rritur ndjeshëm për shkak të IHD-ve. Ato kanë kontribuar në diversifikimin e prodhimit vendas në Shqipëri, duke krijuar punësim dhe duke furnizuar me teknologji, njohuri dhe aftësi menaxhimi. Prania e shoqërive të huaja ka rritur gjithashtu konkurrueshmërinë dhe cilësinë e mjedisit vendas për biznesin. Investimet e huaja direkte janë të dobishme për Shqipërinë në shumë drejtime, por hapja nuk duhet të jetë e pakushtëzuar. Duhet të jetë e balancuar me instrumente për të ruajtur sigurinë dhe rendin e saj publik.

- Organizata Botërore e Tregtisë (2000)
- Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Evropës Qendrore (2006)
- Shoqata Evropiane e Tregtisë së Lirë (2009)
- Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit e BE-së (2009)
- Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut (2009)
- Shqipëria paraqiti kërkesën e saj për anëtarësim në Bashkimin Evropian (2009)
- Statusi i kandidatit të BE-së për Shqipërinë (qershor 2014)
- Negociatat për anëtarësimin në BE (korrik 2022)

Kalimi nga një ekonomi shtetërore dhe e centralizuar në një ekonomi të decentralizuar të bazuar tek tregu, ka sjellë shumë sfida të rëndësishme ekonomike për Shqipërinë. Në të kaluarën, Shqipëria ka bërë përpjekje për të rritur klimën e saj të investimeve dhe për të tërhequr investimet e huaja direkte përmes një sërë nismash dhe reformash. Nismat më në zë janë:

Ligji për investimet e huaja⁶³: Ligji nr. 7764 “Për investimet e huaja”, i miratuar në nëntor 1993, krijoi një mjedis investimi mikpritës duke siguruar trajtim të barabartë për investitorët vendas dhe të huaj. Kështu, Shqipëria miratoi një kornizë ligjore liberale në lidhje me *investimet e huaja*.

Klima miqësore e investimeve të Shqipërisë vërtetohet më tej nga Indeksi i Kufizimit të IHD-ve të OECD-së, i cili vlerëson se Shqipëria është më pak kufizuese ndaj IHD-ve sesa ekonomia mesatare e OECD-së.⁶⁴

⁶³ Ligji nr. 7764, datë 2.11.1993 “Për investimet e huaja” i ndryshuar.

⁶⁴ OECD, “Konkurrueshmëria në Evropën Juglindore 2021, një perspektivë e politikës: Shqipëria”.

KUTIA 6

Pse Shqipëria konsiderohet vend miqësor për investime?

- ▶ Nuk nevojitet autorizim paraprak.
- ▶ Nuk është i mbyllur asnjë sektor ndaj investimeve të huaja.
- ▶ Nuk ka kufizime për sa i takon përqindjes së pjesëmarrjes së huaj tek shoqëritë (me përjashtim të disa sektorëve të caktuar).
- ▶ Riatdhesim i lirë i kapitalit dhe fitimeve.
- ▶ Sistemi tatimor i Shqipërisë nuk bën dallime mes investitorëve të huaj dhe atyre vendas.
- ▶ Investimet e huaja nuk mund të shpronësohen ose shtetëzohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë (përveçse për qëllime publike të përcaktuara me ligj).
- ▶ Investimet dhe investitorët e huaj dhe vendas marrin trajtim të barabartë.
- ▶ Investitorët në Shqipëri gëzojnë të drejtën e mbrojtjes gjyqësore të të drejtave ligjore që lidhen me investimet e tyre.

Programi i privatizimit: Përgjatë viteve 1990 dhe fillimit të viteve 2000, Shqipëria zbatoi një program privatizimi në shkallë të gjerë për të transferuar ndërmarrjet shtetërore në pronësi private. Ky program synonte të tërhiqte investitorë vendas dhe të huaj dhe të nxiste rritjen ekonomike të drejtuar nga tregu.

Ngritja e një institucioni të dedikuar për IHD-të: U krijua Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), e cila sipas Ligjit nr. 10303, datë 15.07.2010, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve” funksionon si një institucion qeveritar përgjegjës për nxitjen e investimeve në Shqipëri. AIDA ofron informacion dhe ndihmë për investitorët e mundshëm, lehtëson procedurat e investimeve dhe promovon Shqipërinë si një destinacion investimesh.

Stimujt fiskalë dhe administrativë: Qeveria shqiptare ofron stimuj të ndryshëm fiskalë për të tërhequr investime, *ndër të tjera*, përjashtime ose reduktime tatimore dhe trajtim preferencial për projektet strategjike ose bizneset e orientuara nga eksporti. Shqipëria ka nënshkruar traktate për shmangien e tatimit të dyfishtë me 43 vende.⁶⁵

TDI-të dhe marrëveshjet tregtare: Në vitin 1995, Shtetet e Bashkuara dhe Shqipëria nënshkruan Traktatin Dypalësh për Investimet (TDI), i cili siguron që investitorët amerikanë të marrin trajtim kombëtar dhe të kombit më të favorizuar, si dhe parashikon zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.⁶⁶ Për më tepër, Shqipëria ka lidhur traktate dypalëshe për nxitjen dhe favorizimin e investimeve me 45 vende⁶⁷ dhe ka nënshkruar marrëveshje të tregtisë së lirë me BE-në, vendet e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (Maqedoninë e Veriut, Malin i Zi, Serbinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Kosovën dhe Moldavinë), Vendet e Shoqatës Evropiane të Tregtisë së Lirë (Zvicrën, Lihtenshtejnin, Norvegjinë, Islandën) dhe Turqinë.

⁶⁵ Lista e traktateve mund të gjendet në <https://www.tatime.gov.al/c/6/125/marreveshje-nderkombetare.%C2%A0>.

⁶⁶ Traktati Dypalësh për Investimet mund të gjendet në <https://www.state.gov/investment-affairs/bilateral-investment-treaties-and-related-agreements/united-states-bilateral-investment-treaties/>.

⁶⁷ Lista e TDI-ve mund të gjendet në <https://investmentpolicy.unctad.org/international-investment-agreements/countries/2/albania>.

Është e rëndësishme të theksohet se efektiviteti dhe ndikimi i nismave të lartpërmendura, si dhe suksesi i tyre në tërheqjen e investimeve varet nga faktorë të ndryshëm, siç janë situata e përgjithshme ekonomike, stabiliteti politik, sundimi i ligjit, zhvillimi i infrastrukturës dhe besimi i investitorëve.

Ligji për investimet strategjike: Në vitin 2015, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 55/2015 “Për investimet strategjike” me qëllim tërheqjen e investitorëve të huaj dhe vendas në sektorët kryesorë. Ligji 55/2015 parashikon një sërë stimuljesh, kushtesh të favorshme dhe procedurash bashkëkohore për investitorët strategjikë që operojnë në Shqipëri.

KUTIA 7

Sektorët Strategjikë Ekonomikë në Shqipëri

- ▶ Energjia dhe minierat;
- ▶ Transporti, infrastruktura e komunikimeve elektronike dhe mbetjet urbane;
- ▶ Turizmi (strukturat turistike);
- ▶ Bujqësia (fermat e mëdha bujqësore) dhe peshkimi;
- ▶ Zonat ekonomike;
- ▶ Zona me përparësi zhvillimi.

Qëllimi kryesor është nxitja dhe tërheqja e investimeve vendase dhe të huaja në sektorët strategjike të sipërpërmendur duke vendosur procedura administrative të favorshme, të lehta dhe të përshtetshme për investitorët. Ligji 55/2015 nuk parashikon asnjë lloj kontrolli për arsye të sigurisë kombëtare dhe rendit publik.

Fillimisht i menduar si një regjim i përkohshëm dhe jetëshkurtër, efektiviteti i Ligjit nr. 55/2015 është zgjatur disa herë dhe tani është planifikuar të mbetet në fuqi deri në fund të vitit 2023. Ndërsa miratimi i ligjit nr. 55/2015 kishte pritshmëri të larta, potenciali i tij i plotë në drejtim të investimeve të huaja ende nuk është realizuar. Ligji nr. 55/2015 ka sjellë përfitime kryesisht për investitorët vendas dhe jo ata të huaj.

Sipas një hetimi të kryer nga Euronews Albania,⁶⁸ 7 vjet pas miratimit të ligjit, 17 investim të drejtuar nga shoqëri me pronësi shqiptare janë përcaktuar si “strategjike” krahasuar me vetëm 2 investime të drejtura nga shoqëri me pronësi të huaj. Nga të dhënat e mbledhura nga hetimi rezulton se shoqëritë shqiptare kanë investuar gjithsej 435 milionë euro, ndërsa shoqëritë e huaja kanë investuar rreth 64 milionë euro. Sektori i turizmit ka tërhequr nivelin më të lartë të investimeve, duke zënë afërsisht 85% të totalit të investimeve. Këto investime janë drejtuar kryesisht drejt ndërtimit të resorteve të reja. Në të kundërt, rreth 15% e investimeve janë ndarë në sektorët e bujqësisë dhe energjisë. Duhet të theksohet se të dhënat e siguruar nga Euronews Albania nuk përfshijnë projektin e Marinës së Durrësit dhe Jahteve, një sipërmarrje e përbashkët mes shtetit shqiptar dhe një shoqërie me seli në Emiratet e Bashkuara Arabe. Vlerësimet paraprake sugjerojnë se vetëm ky projekt mund të tejkalojë 2 miliardë euro në vlerë investimi.

Si përfundim, megjithëse Ligji 55/2015 u zbatua me qëllim tërheqjen e investitorëve të huaj dhe vendas në sektorët kryesorë, ndikimi i ligjit në investimet e huaja ka qenë relativisht i kufizuar.

⁶⁸ <https://euronews.al/en/85-of-strategic-investors-are-albanians/>; Parë për herë të fundit më 12.06.2023.

Pjesa më e madhe e investimeve kanë ardhur nga shoqëri me pronësi shqiptare, veçanërisht në sektorin e turizmit.

Ndër ligje të tjera të zbatuara janë ligji nr. 10 303, datë 15 korrik 2010 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)”; Ligji nr. 9789, datë 19.07.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike”, i ndryshuar.

4.2.2. Kuadri institucional dhe qeverisja

Subjekte dhe agjenci të ndryshme qeveritare janë përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e politikave, rregulloreve dhe nismave për tërheqjen dhe lehtësimin e investimeve. IHD-të promovohen, mbështeten dhe lehtësohen nga institucionet kryesore në Shqipëri, të cilat janë si vijon:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë: është përgjegjëse për zhvillimin e politikave ekonomike, përfshirë ato që kanë të bëjnë me investimet. Kjo ministri luan një rol vendimtar në krijimin e një klime të favorshme për investimet, zbatimin e masave dhe politikave të nxitjes së investimeve dhe mbikëqyrjen e rregulloreve që kanë të bëjnë me investimet, duke krijuar kështu një klimë të favorshme biznesi dhe duke tërhequr IHD-të.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë: është përgjegjëse për mbikëqyrjen e investimeve në energji dhe sigurimin e mbështetjes për investitorët në sektorin e energjisë. Kjo ministri përqendrohet në zhvillimin ekonomik, politikat tregtare dhe investimet e sektorit të energjisë. Ajo luan një rol në hartimin e strategjive për tërheqjen e investimeve, krijimin e një mjedisi miqësor për biznesin, si dhe zbatimin e rregulloreve e politikave përkatëse.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit: përqendrohet në tërheqjen e investimeve në industrinë e turizmit dhe promovimin e praktikave të qëndrueshme mjedisore. Kjo ministri luan një rol të rëndësishëm në tërheqjen e IHD-ve në sektorin e turizmit dhe promovimin e praktikave të qëndrueshme mjedisore.

Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës (AK)⁶⁹: është përgjegjës për zbatimin e ligjeve për konkurrencën dhe sigurimin e një mjedisi biznesi të drejtë e konkurrues. Ky institucion luan një rol në parandalimin e praktikave anti-konkurruese dhe promovimin e kushteve të barabarta për të gjithë investitorët.

AIDA: është agjencia kryesore qeveritare e dedikuar për tërheqjen, promovimin dhe lehtësimin e IHD-ve në Shqipëri. Ajo ofron informacion, ndihmë e mbështetje për investitorët e mundshëm, duke përfshirë vlerësimin dhe promovimin e projekteve të investimeve. Ajo shërben si një “sportel me një ndalesë” për investitorët e mundshëm, duke iu ofruar atyre informacion; lehtëson procedurat e investimit dhe ofron shërbime mbështetëse gjatë gjithë procesit të investimit. AIDA punon ngushtë me subjektet e tjera qeveritare për tërheqjen dhe ruajtjen e investimeve. Kontributi i drejtpërdrejtë i AIDA-s në zhvillimin ekonomik të vendit del në pah në këto drejtime

- (i) në lehtësimin dhe mbështetjen e IHD-ve në Shqipëri;
- (ii) në rritjen dhe aftësinë konkurruese të ndërmarrjeve të vogla e të mesme;
- (iii) në nxitjen dhe ndihmën ndaj eksporteve të mallrave e të shërbimeve.

⁶⁹ Ligji nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar.

Agjencitë e Zhvillimit Rajonal⁷⁰: Shqipëria ka disa agjenci të zhvillimit rajonal në nivel vendor. Ato punojnë për të promovuar mundësitë për investime rajonale, për të tërhequr investime në rajone të veçanta, si dhe për të mbështetur zhvillimin ekonomik lokal. Këto institucione bashkëpunojnë për të krijuar një ekosistem mikpritës për IHD-të, për të promovuar mundësitë për investime, për të bërë më bashkëkohore procedurat e investimeve, si dhe për t'u ofruar investitorëve mbështetjen e nevojshme përgjatë gjithë rrugëtimit të investimit të tyre në Shqipëri. Përveç institucioneve të sipërcituara, investimet në Shqipëri rregullohen edhe nga shumë ligje, rregullore dhe politika. Ndër to mund të përmendim ligjin për shoqëritë tregtare, ligjin për taksat, Kodin e Punës, rregulloret për mjedisin dhe ligjet specifike të sektorit. Qeveria shqyrton dhe rishikon vazhdimisht këto rregullore për të përmirësuar klimën e investimeve dhe për të siguruar përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare.

4.3. Mekanizmat për shqyrtimin e investimeve në Shqipëri

4.3.1. A ka gjurmë të shqyrtimit të IHD-ve?

Ligji 7764 “Për investimet e huaja”, në asnjë dispozitë tij nuk e pengon Republikën e Shqipërisë të ndërmarrë një veprim që e konsideron të nevojshëm për të ruajtur rendin publik, për të përmbushur angazhimet e saj ndërkombëtare në lidhje me ruajtjen ose vendosjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, ose për të mbrojtur sigurinë kombëtare apo interesat e mbrojtjes. Rrjedhimisht, investimet e huaja mund të kufizohen apo edhe të ndalohen për arsye që lidhen me sigurinë kombëtare dhe rendin publik. Megjithatë, ligji nuk parashikon rastet që mund të vënë në rrezik sigurinë kombëtare dhe rendin publik. Si pasojë e drejtpërdrejtë, mund të argumentohet se autoritetet publike kompetente ruajnë një nivel të konsiderueshëm diskrecioni për të përcaktuar mënyrës se si duhet të interpretohet rendi publik dhe siguria kombëtare.

Legjislacioni shqiptar nuk ka përkufizim të sigurisë kombëtare dhe rendit publik, megjithatë, këto terma janë skalitur si parime bazë në shumë ligje. Duhet të theksohet gjithashtu se nuk ka një përkufizim të njohur ndërkombëtar për sigurinë kombëtare dhe rendin publik. Është e zakonshme që marrëveshjet ndërkombëtare të njohin të drejtat e kombeve sovraane për të zbatuar masa, pavarësisht nga detyrimet e ndërmarra në një marrëveshje të veçantë, për të mbrojtur interesat e tyre thelbësore të sigurisë. Megjithatë, sqarimi në lidhje me rendin publik dhe interesat thelbësore të sigurisë e bën të qartë se masat e marra për arsye për shembull ekonomike, kulturore apo të tjera duhet të identifikohen si të tilla dhe nuk duhet të mbrohen nga një interpretim tepër i zgjeruar i rendit publik dhe interesave thelbësore të sigurisë.⁷¹

Është me rëndësi të theksohet se Gjykata Evropiane e Drejtësisë (GJED) ka përcaktuar se përjashtimet për shkak të sigurisë dhe rendit publik duhet të kenë një interpretim të ngushtë nga Shtetet Anëtare dhe se arsyet tërësisht ekonomike nuk janë të mjaftueshme për të justifikuar këto kufizime. GJED-ja ka pranuar se arsyet me natyrë ekonomike për realizimin e një objektivit për

KUTIA 8

Shembull i shqyrtimit sektorial

Ligj nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, i ndryshuar, parashikon se për shkak të shqetësimeve për sigurinë kombëtare, ministria përgjegjëse mund të refuzojë lidhjen apo transferimin e marrëveshjes për ndarjen e hidrokarbureve.

⁷⁰ https://rdatirana.al/?page_id=23.

⁷¹ OECD, Masat e sigurisë kombëtare (shënim nga Sekretariati), 21 nëntor 1995, DAFE/MAI (95) 7.

interesin publik ose për të garantuar një shërbim me interes të përgjithshëm mund të përbëjnë një arsye mbizotëruese në interesin publik të aftë për të justifikuar një pengesë për një nga liritë themelore të sanksionuara në Traktatet e BE-së.⁷² Pavarësisht nga fakti se Shtetet Anëtare janë ende, në parim, të lira të përcaktojnë kërkesat e politikës publike dhe sigurisë publike, në varësi të nevojave të tyre kombëtare, këto baza, në kontekstin e BE-së dhe, në veçanti, si përjashtim nga një liri themelore e sanksionuar në Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian, duhet të interpretohen në mënyrë rigorozë, në atë mënyrë që sfera e veprimit të tyre të mos përcaktohet në mënyrë të njëanshme nga secili shtet anëtar pa asnjë kontroll nga institucionet e BE-së. Kështu, politika publike dhe siguria publike mund të mbështeten vetëm nëse ekziston një kërcënim i mirëfilltë dhe mjaft serioz për interesin themelor të shoqërisë. Për më tepër, këto përjashtime nuk duhet të shpërdorohen në atë mënyrë që, në fakt, të shërbejë për qëllime tërësisht ekonomike.⁷³

Aktualisht, në Shqipëri mungon një mekanizëm zyrtar shqyrtimi, i cili të mundësojë kufizimin ose ndalimin e një IHD-je që mund të ketë implikime për sigurinë ose rendin publik. Nuk ka asnjë kërkesë që investimet e huaja të miratohen paraprakisht ose të shqyrtohen nga një organ rregullator, edhe pse investitorët e huaj duhet të jenë në përputhje me ligjin shqiptar kur hyjnë në tregun shqiptar, në varësi të llojit të aktivitetit që do të zhvillohet (financiar, energjetik dhe minerar, transport, infrastrukturë të komunikimeve elektronike, etj.).

Pavarësisht se legjislacioni në fuqi kontrollon dhe zbaton kufizimet, ligjet nuk parashikojnë *në vetvete* kontrollin për arsye të sigurisë kombëtare dhe rendit publik.

Në praktikë, kanë ndodhur disa raste që mund të lidhen me nevojën për shqyrtimin e investimeve. Për shembull, në vitin 2020, Shqipëria iu bashkua një nisme të Departamentit Amerikan të Shtetit të quajtur “Rrjeti i Pastër”, e cila synonte të trajtonte kërcënimet afatgjata për privatësinë e të dhënave, sigurinë dhe të drejtat e njeriut⁷⁴. Ky Rrjet përjashtonte anëtarët nëse do të përdorin çdo lloj shërbimi 5G nga “shitës të pabesueshëm të TI-së”, përfshirë Huawei-n dhe ZTE-në. Rruga e drejtë drejt 5G-së përshkruhet si një “kanal komunikimi nga skaji në skaj që nuk përdor asnjë pajisje transmetimi, kontrolli, llogaritjeje apo ruajtjeje” nga asnjë prej këtyre shoqërive.⁷⁵

4.3.2. A ka ndonjë kufizim sektorial?

Legjislacioni shqiptar parashikon *de jure* disa kufizime për pasjen e pronësisë nga të huajt në disa sektorë të përzgjedhur.



Transporti ajror⁷⁶: një sipërmarrës (transportues ajror) duhet të pajiset me licencë operimi nga autoriteti kompetent i licencimit (p.sh., Autoriteti Shqiptar i Aviacionit Civil) me kusht që (i) të jetë më shumë se 50% në pronësi dhe nën kontrollin efektiv të shtetit shqiptar dhe/ose shtetasve shqiptarë, përveç rasteve të parashikuara në një marrëveshje me një vend të tretë në të cilën Shqipëria është palë; ose (ii) të jetë më shumë se 50% në pronësi dhe nën kontrollin efektiv të një ose më shumë shteteve palë të marrëveshjes

⁷² Gjykata e Drejtësisë e 13 korrikut 2023, 22 tetor 2013, Essent dhe të tjerë, C 105/12; Gjykata e Drejtësisë e 13 korrikut 2023, Xella Magyarországgal Építőanyagipari Kft., C-106/22.

⁷³ Gjykata e Drejtësisë e 14 marsit 2000, Église de scientologie, C 54/99; Gjykata e Drejtësisë e 13 korrikut 2023, Xella Magyarországgal Építőanyagipari Kft., C-106/22.

⁷⁴ <https://exit.al/en/albania-joins-us-the-clean-network-pledges-not-to-use-huawei-5g/>

⁷⁵ <https://20172021.state.gov/thecleannetwork/#:~:text=5G%20Clean%20Countries%20and%20Clean,to%20develop%20its%20G%20infrastructure>

⁷⁶ Ligj nr. 96 datë 23.07.2020 “Për Kodin Ajror të Republikës së Shqipërisë”.

shumëpalëshe për Zonën e Përbashkët Evropiane për Aviacionin ose shtetasve të tyre, përveç nga sa mund të parashikohet në një marrëveshje me një vend të tretë (jashtë Zonës së Përbashkët Evropiane për Aviacionin) në të cilën Shqipëria ose Komuniteti Evropian është palë.




Aktiviteti i peshkimit⁷⁷: shtetasit e huaj nuk mund të zotërojnë më shumë se 49% të kapitalit të anijeve që mbajnë flamur shqiptar ose të shoqërive tregtare që merren me peshkimin tregtar.



Toka: Asnjë shtetas i huaj ose shoqëri e huaj nuk mund të blejë tokë bujqësore, megjithëse toka mund të jepet me qira deri në 99 vjet.⁷⁸ Është për tu theksuar se Ligji Nr. 93 datë 27.07.2015 “Për turizmin” nxit investitorët potencialë të investojnë në resorte turistike duke ofruar tokë shtetërore përmes skemës “Shqipëria 1 euro” për një periudhë 99 vjeçare. Trojet e ndërtimit shtetërore ose private mund të blihen nga investitorët e huaj vetëm nëse investimi i tyre shkon sa trefishi i vlerës së çmimit të tokës.

Investitorët e huaj që kryejnë ose janë aktualisht të përfshirë në investime në Shqipëri kanë të drejtë të blejnë tokë për qëllime investimi. Kjo përfshin si tokën në pronësi të shtetit ashtu edhe atë private, si dhe tokën që është e lidhur me investimin e përfunduar ose në vazhdim.

Megjithatë, për të vijuar me blerjen, vlera e investimit duhet të jetë të paktën sa trefishi i vlerës së tokës.⁷⁹



⁷⁷ Ligj nr. 64/2012 “Për peshkimin”, i ndryshuar.

⁷⁸ Ligji nr. 8337, datë 30.04.1998 “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjeve, livadheve dhe kullotave”.

⁷⁹ Ligj nr. 7980, datë 27.07.1995 “Për shitblerjen e trojeve”.

Mediat audiovizive: Në vitin 2013, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin Nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i cili shfuqizoi ligjin Nr. 8410/1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji Nr. 97/2013 parashikonte se asnjë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, nuk mund të kishte në zotërim më shumë se 40% të kapitalit të përgjithshëm aksionar të një shoqërie aksionare mbajtëse e një licence kombëtare për transmetimet audio ose audiovizive.

Ky kufizim u aplikua për subjektet vendase dhe të huaja deri në vitin 2016 kur Gjykata Kushtetuese (me vendimi Nr. 56, datë 27.07.2016) doli në përfundimin se kufizimi i pronësisë së medias është antikushtetues.

KUTIA 9

Kufizimi i pronësisë së medias është antikushtetues

Shoqata Shqiptare e Mediave Elektronike e çoi çështjen para Gjykatës Kushtetuese për të shfuqizuar pikën 3 të nenit 62 të ligjit Nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Gjykata Kushtetuese doli në përfundimin se: “55. [...] mjetet e zgjedhura nga ligjvënësi për të kufizuar pronësinë e shoqërive që operojnë në fushën e medias nuk janë të arsyeshme dhe proporcionale në lidhje me qëllimin legjitim të ligjvënësit për pluralizmin e informacionit. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se nisma e ligjvënësit nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit, andaj pika 3 e nenit 62 të ligjit për median duhet të shfuqizohet.”

Gjykata Kushtetuese kreu gjithashtu një analizë krahasuese mes situatës në Shqipëri dhe vendeve fqinje, si Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Kosova, zhvillimet ekonomike, politike dhe strukturore të cilave janë të krahasueshme me ato të Shqipërisë. Asnjë nga këto vende nuk ka miratuar një kufizim të ngjashëm me atë të përcaktuar nga ligji shqiptar për mediat audiovizive. Për më tepër, vendet e BE-së, si Kroacia, Rumania e Italia nuk kanë vendosur asnjë kufizim të ngjashëm me pikën 3 të nenit 62 të ligjit për median, ndërsa Franca, Austria dhe Polonia kanë kufizime deri në 49% të aksioneve, por vetëm për personat e huaj fizikë ose juridikë, të cilët janë aksionarë të një shoqërie mediatike mbajtëse e një licence kombëtare.

4.3.3. Miratimi i një ligji të unifikuar për investimet

Shqipëria, ashtu si shumë vende të tjera, pranon se investimet, qofshin ato private apo publike, konsiderohen si motori kryesor për të siguruar rritje ekonomike afatgjatë dhe të qëndrueshme të vendit. Për më tepër, riorientimi i ekonomisë drejt një modeli të bazuar në investime (dhe të orientuar drejt eksportit) hedh themelet për zhvillimin e qëndrueshëm në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.⁸⁰ Prandaj, është me rëndësi të madhe të zgjerohet kuadri ligjor aktual duke e sjellë atë në përputhje me ndryshimet rajonale dhe praktikat aktuale më efektive.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka publikuar projektligjin “Për investimet” që nga viti 2019. Ky projektligj synon të shfuqizojë ligjet ekzistuese (si p.sh. ligjin nr. 7764, datë 2 nëntor 1993 “Për investimet e huaja” dhe ligjin nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”).

Puna për hartimin e tij nisi në janar 2017, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 579, datë 3 gusht 2016 “Për miratimin e udhëzimit për politikën e investimeve të Qeverisë Shqiptare”,

⁸⁰ Dokumenti i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI 2015-2020, faqe 33).

sipas të cilit një ligj i ri për investimet është ndër reformat që do të zbatohen. Ai është konceptuar si një zbatim i drejtpërdrejtë i parimeve kushtetuese, përkatësisht barazia e të drejtave dhe lirive themelore mes shtetasve shqiptarë dhe atyre të huaj, ose pa shtetësi në territorin e Shqipërisë (pra, shtetasit pa shtetësi)⁸¹, barazinë para ligjit, ndalimin e diskriminimit⁸², të drejtën për pronë private⁸³ dhe të drejtën⁸⁴ për një proces të rregullt ligjor e kushtetutës në Republikën e Shqipërisë.⁸⁵ Për më tepër, angazhimi i qeverisë shqiptare për të forcuar klimën e investimeve u shpreh në programin e saj politik për periudhën 2017-2021.⁸⁶ Gjatë vitit 2019, Këshilli i Investimeve të Shqipërisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Korporatën Financiare Ndërkombëtare, organizuan disa raunde konsultimesh për projektligjin “Për ligjin e unifikuar të investimeve” me një grup të madh aktorësh, të cilët dhanë një numër rekomandimesh.⁸⁷ Që nga ajo kohë, nuk ka pasur asnjë përditësim nga ana e qeverisë për statusin e projektligjit. Me sa duket, ky proces është shtyrë pasi qasja e qeverisë ishte të zgjaste kohëzgjatjen e zbatimit të ligjit aktual nr. 55/2015 “Për investimet strategjike” përmes ndryshimeve të njëpasnjëshme.

Nevoja për të krijuar një projektligj për investimet lindi për shkak se legjislativi ekzistues në Republikën e Shqipërisë siguron mbrojtje të shtuar për investimet e huaja, ndërsa investimet vendase nuk gëzojnë masa mbrojtëse të ngjashme. Për pasojë, u prezantua një kuadër ligjor i veçantë për investimet strategjike. Për më tepër, legjislativi aktual vlerësohet si i

pamjaftueshëm, sepse siguron mbrojtje vetëm sipërfaqësore dhe deklarative për investitorët e huaj, pa përfshirë praktikën dhe standardet më të mira ndërkombëtare në këtë fushë. Në këto rrethana, pritej që hartimi i një ligji të unifikuar për investimet, i cili mbron investimet vendase dhe ato të huaja, përfshirë parimet e transparencës, barazisë dhe trajtimit jodiskriminues të investitorëve, do të rriste besueshmërinë e investitorëve.

Një ligj i unifikuar për investimet është i dobishëm pasi iu siguron investitorëve një kuadër të qartë dhe të qëndrueshëm, zvogëlon pengesat burokratike dhe promovon transparencën, parashikueshmërinë dhe llogaridhënien.

Projektligji, sipas raportit shpjegues, është rezultat i një analize gjithëpërfshirëse të 44 TDI-ve dhe kërkon të përmbushë detyrimet e përshkruara në traktatet dypalëshe për investimet, në të cilat Shqipëria është palë nënshkruese. *Projektligji për investimet ka për qëllim:*

- (i) të përditësojë legjislativin ekzistues për investimet në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare;*
- (ii) të krijojë një kuadër të ri ligjor të unifikuar dhe konkurrues për të tërhequr investime vendase dhe të huaja;*
- (iii) të sigurojë përputhjen me legjislativin e brendshëm dhe marrëveshjet ndërkombëtare;*
- (iv) të krijojë një mekanizëm efikas për zgjidhjen e shpejtë dhe të drejtë të mosmarrëveshjeve në fushën e investimeve.*

⁸¹ Neni 16 i Ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

⁸² Neni 18 i Ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

⁸³ Neni 41 i Ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

⁸⁴ Neni 42 i Ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

⁸⁵ Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar.

⁸⁶ Programi politik i Qeverisë Shqiptare 2017-2021, faqe 5,

https://kryeministria.al/wp-content/uploads/2021/10/Programi_Qeverises_2021-2025.pdf

⁸⁷ <https://www.investment.com.al/2019/06/27/on-draft-unified-investment-law-consultation-with-business-stakeholders/>

Në vitin 2017 (koha e hartimit të ligjit), BE-ja tha se shteteve anëtare nuk kërkohen të zbatojnë një procedurë shqyrtimi. Për rrjedhojë, ligjvënësi shqiptar nuk kërkoi detyrimisht asnjë shqyrtim ex-ante apo ex-post të IHD-ve. Deri më sot, nuk është prezantuar asnjë nismë për të zbatuar një mekanizëm shqyrtimi. Pavarësisht se projektligji është propozuar në vitin 2019, duhet të theksohet se nuk është miratuar ende.

4.4. Vënia në zbatim e një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe sistematike për kuadrin ligjor dhe të politikave për investimet

Mes diskutimeve të vazhdueshme për miratimin e një ligji të ri gjithëpërfshirës për investimet që do të ndryshonte ndjeshëm kuadrin e investimeve dhe përballë tendencave në zhvillim për krijimin e mekanizmave të shqyrtimit në nivel shtetëror, duhet të merren parasysh kornizat tashmë të krijuara për të informuar diskutimet dhe për të udhëhequr rrugën.

4.4.1. Treguesit e cilësisë së IHD-ve

Pa dyshim që IHD-të kanë rëndësi në terma sasiorë, por mungon një kuadër i qartë për matjen e saktë të ndikimit të tyre cilësor. Ndërsa ekzistojnë avantazhe të supozuara që lidhen me IHD-të, të tilla si injektimi i fondeve, transferimi i njohurive dhe përhapja e teknologjisë, është e rëndësishme të pranohet se ato mund të përdoren gjithashtu qëllimisht për të ndjekur objektiva që nuk orientohen nga tregut ose jo qëllimisht të kenë efekte negative në ekonomi. Kjo nismë pranon nevojën për një vlerësim gjithëpërfshirës që shkon përtej masave të thjeshta monetare, duke lejuar një kuptim më me nuanca të ndikimit të IHD-ve në dimensione të ndryshme të ekonomisë.

Në përputhje me angazhimin e saj ndaj Planit të Veprimit për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) dhe në njohje të nevojës për një kuptim më të thellë të lidhjes midis IHD-ve dhe OZHQ-ve, OECD-ja prezantoi Nismën për Cilësitë e IHD-ve në vitin 2018. Qëllimi kryesor i kësaj nisme është të pajisë politikëbërësit me një instrument pragmatik për të mobilizuar IHD-të që maksimizojnë rritjen gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, ndërsa njëkohësisht avancojnë progresin drejt OZHQ-ve.⁸⁸

Nisma e Cilësive të IHD-ve përqendrohet në potencialin e investitorëve të huaj, përveç kontributeve të tyre financiare, për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm përmes përhapjes së njohurive. Nisma e Cilësive të IHD-ve mbështetet nga Treguesit e Cilësive të IHD-ve, të cilët përpiqen të sqarojnë se si investimet e huaja ndërlidhen me dimensione specifike të zhvillimit të qëndrueshëm në vendet pritëse. Treguesit janë strukturuar rreth tre dimensioneve thelbësore të Agjendës 2030 që zakonisht referohet si PNJP: prosperiteti, njerëzit dhe planeti. Ato përfshijnë qëndrueshmërinë ekonomike, sociale dhe mjedisore. Treguesit e Cilësive të IHD-ve aktualisht përqendrohen në pesë grupe që rrjedhin nga tre PNJP-të: produktiviteti dhe inovacioni, punësimi dhe cilësia e punës, aftësitë, barazia gjinore dhe gjurma e karbonit. Brenda secilit grup, janë identifikuar dhe përdorur rezultate të shumta për të gjeneruar tregues që krijojnë lidhje mes këtyre rezultateve dhe IHD-ve ose aktiviteteve të ndërmarrjeve të huaja shumëkombëshe (NHSH). Përmes shqyrtimit të këtyre treguesve, politikëbërësit kanë mundësi të shqyrtojnë kompromiset e qëndrueshmërisë brenda dhe nëpër grupe, duke fituar kështu njohuri të vlefshme për kontributet e mundshme të IHD-ve në zhvillimin e qëndrueshëm. Duke marrë parasysh faktorët unikë kontekstualë të vendeve të tyre përkatëse, politikëbërësit mund të përdorin Treguesit e Cilësive të IHD-ve si një mjet për të vlerësuar përafrimin e IHD-ve me objektivat e politikave kombëtare, për të identifikuar sfidat dhe për të identifikuar fushat që kërkojnë ndërhyrje në politika. Nisma e

⁸⁸ OECD, "Treguesit e cilësive të IHD-ve: matja e ndikimeve të zhvillimit të qëndrueshëm të investimeve", 2021.

Cilësive të IHD-ve përfaqëson një hap kritik për të trajtuar hendekun e njohurive dhe për të kuptuar rolin efektiv që IHD-të mund të luajnë në nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm. Duke u ofruar politikëbërësve një instrument gjithëpërfshirës për të vlerësuar aspektet cilësore të IHD-ve, nisma ka potencialin t'i pajisë ata me mjete për të shfrytëzuar investimet e huaja në mbështetje të OZHQ-ve kombëtare, për të identifikuar fushat për përmirësim dhe nxitjen e hartimit të politikave të bazuara në dëshmi për të arritur rritje të qëndrueshme afatgjatë.⁸⁹

Tabela 3: Cilësitë e IHD-ve sipas grupit të qëndrueshmërisë dhe rezultateve⁹⁰

GRUPIMI	OBJEKTIVI	REZULTATET
PRODUKTIVITETI DHE INOVACIONI	Të ofrohet informacion mbi shkallën në të cilën NHH-të e huaja dhe lidhjet e tyre me firmat vendase mund të bëjnë të mundur rritjen e produktivitetit dhe rritjen e kapacitetit të inovacionit përmes transferimit të njohurive dhe teknologjisë.	Produktiviteti i punës, rritja e produktivitetit të punës, inovacioni i produktit, inovacioni i procesit, shpenzimet në kërkim dhe risi, si dhe përdorimi i teknologjive të huaja.
PUNËSIMI DHE CILËSIA E PUNËS	Të eksplorohet se si IHD-të lidhet me punësimin dhe cilësinë e punës në vendet pritëse. Cilësia e punës është thelbësore për të siguruar që punonjësit të punojnë në mënyrë produktive.	Krijimi i vendeve të punës për njësi të IHD-ve, rritja e punësimit, pagat, siguria e punës (puna e përkohshme) dhe siguria e punëtorëve (lëndimet).
AFTËSITË	Të hetohet se deri në çfarë mase NHH-të e huaja do të investojnë në kapitalin njerëzor dhe aftësitë, drejtpërdrejt përmes trajnimeve të brendshme të punonjësve dhe menaxherëve dhe në mënyrë të tërthortë përmes transferimit të njohurive në firmat vendase.	Intensiteti i aftësive, trajnimi në punë dhe mungesa/teprica e aftësive teknike.
BARAZIA GJINORE	Të shqyrtohet se si IHD-të lidhen me barazinë gjinore në ekonomitë pritëse.	Hendeku gjinor i punësimit, hendeku gjinor i pagave, menaxheret e larta drejtuese gra (fuqizimi i grave) dhe sipërmarrjen e grave.
GJURMA E KARBONIT	Të studiohet shkalla në të cilën IHD-të lidhen me gjurmën e karbonit dhe se si IHD-të po kontribuojnë në tranzicionin e energjisë me karbon të ulët.	Emetimet e CO ₂ , eficienta e energjisë dhe energjia e rinovueshme.

4.4.2. Udhëzimet e OECD-së për NHH-të

Udhëzimet e OECD-së për ndërmarrjet shumëkombëshe për sjelljen e përgjegjshme të biznesit janë një grup rekomandimesh dhe parimesh të hartuara për të promovuar sjelljen e përgjegjshme nga NHH-të në një kontekst global. Këto udhëzime, të zhvilluara nga OECD-ja, ofrojnë standarde dhe udhëzime vullnetare që NHH-të të ndjekin në operacionet e tyre të biznesit.⁹¹ Udhëzimet mbulojnë një gamë të gjerë fushash, duke përfshirë të drejtat e njeriut, punën, mjedisin, ryshfetin dhe korrupsionin, interesat e konsumatorëve e më shumë. Ato synojnë të trajtojnë rreziqet e mundshme dhe ndikimet negative që lidhen me aktivitetet e NHH-ve dhe të inkurajojnë shoqëritë që të kontribuojnë pozitivisht në zhvillimin e qëndrueshëm dhe rritjen ekonomike.

⁸⁹ OECD "Treguesit e cilësive të IHD-ve: 2022", 2022.

⁹⁰ OECD "Treguesit e cilësive të IHD-ve – çështjet më të rëndësishme".

⁹¹ OECD (2023), Udhëzimet e OECD-së për ndërmarrjet shumëkombëshe.

Duke iu përmbajtur Udhëzimeve të OECD-së, NHSH-të angazhohen të respektojnë standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira, të nxisin transparencën dhe të angazhohen në dialog me palët përkatëse të interesit. Udhëzimet theksojnë rëndësinë e vigjilencës së duhur, vlerësimin e rrezikut dhe mekanizmeve efektivë të ankesave për të siguruar llogaridhënie dhe sjellje të përgjegjshme në të gjithë zinxhirin e furnizimit.⁹² Udhëzimet e OECD-së nuk janë ligjërish të detyrueshme, por ato shërbejnë si një kuadër referimi për qeveritë, bizneset dhe organizatat e shoqërisë civile në mbarë botën.

Secili vend anëtar do të caktojë pikën kombëtare të kontaktit (PKK) për të promovuar dhe lehtësuar zbatimin e udhëzimeve. Një nga përgjegjësitë e PKK-ve është dhënia e ndihmesës me anë të një mekanizmi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, i cili njihet si “instancë e posaçme”. Kjo procedurë përdoret kur një PKK sjell në vëmendje një mosrespektim të pretenduar të një ose më shumë prej rekomandimeve të parashikuara nga Udhëzimet. Në këto raste, PKK-ja merr rolin e lehtësuesit të procesit të zgjidhjes duke ofruar qasje në procedura konsensuale dhe jo kundërshtuese, duke ndihmuar kështu palët e përfshira në trajtimin e çështjeve të ngritura.

Ky kuadër bashkëpunimi mes biznesit dhe autoritetit publik sjell dobi:

- Forcon dialogun mes palëve të ndryshme të interesit për rëndësinë e sjelljes së përgjegjshme të biznesit;
- Ofron një bashkëpunim më të ngushtë dhe konkret mes sektorit publik e privat, me fokus përmirësimin e klimës së biznesit në Shqipëri;
- Mbështet rritjen e besimit të ndërmarrjeve që operojnë aktualisht në Shqipëri;
- Rrit mundësitë për të tërhequr investime të huaja më të përgjegjshme në Shqipëri;
- Udhëzimet e OECD-së për NHSH-të janë një instrument që ndihmon në promovimin e vendit si një destinacion tërheqës për të investuar dhe tregtuar;
- Një mekanizëm me vlerë të shtuar në rrugën e Shqipërisë drejt integritimit në BE.

Në këtë kontekst, gjatë kësaj faze vendimtare në lidhje me kuadrin e investimeve në Shqipëri, Udhëzimet e OECD-së për NHSH-të dhe krijimin e PKK-ve mund të merren në konsideratë për promovimin e një klime të qëndrueshme investimesh në Shqipëri.

4.4.3. Kuadri i kapitalit gjërryes dhe kapitalit të strukturuar

CIPE ka ndërmarrë një iniciativë për zhvillimin e një kuadri gjithëpërfshirës me qëllim analizimin e investimeve të huaja, duke i kushtuar vëmendje dallimit mes termave dalluese të kapitalit gjërryes dhe atij të strukturuar.⁹³ Ky kuadër shërben si një mjet për të shqyrtuar dhe kuptuar ndikimin e investimeve të huaja në vendet pritëse, duke hedhur dritë mbi rreziqet dhe përfitimet e mundshme që lidhen me këto flukse të kapitalit.⁹⁴

Koncepti i kapitalit gjërryes i referohet investimeve të huaja që janë të dëmshme për stabilitetin ekonomik, social dhe politik të vendit pritës. Këto investime përfshijnë shpesh praktika shfrytëzuese, nuk janë transparente dhe minojnë qeverisjen e mirë. Kapitali gjërryes mund të çojë në pasoja negative, duke përfshirë “erozionin” e institucioneve demokratike, rritjen e korrupsionit, si dhe përqendrimin e pushtetit ekonomik në duart e një numri të vogël personash. Ky kuadër i CIPE-s lejon kryerjen e një analize sistematike të këtyre aspekteve të dëmshme të investimeve të

⁹²Ibid.

⁹³ CIPE, "Një kuadër për kapitalin e strukturuar: investimi, integriteti dhe ndikimi", prill 2022; adresa zyrtare e CIPE-s për kapitalin e strukturuar dhe gjërryes: <https://corrosiveconstructivecapital.cipe.org>

⁹⁴ <https://corrosiveconstructivecapital.cipe.org/>.

huaja, duke iu ofruar politikëbërësve dhe palëve të interesit mundësinë të identifikojnë dhe zbusin rreziqet e mundshme që shoqërohen me kapitalin gjërryes.⁹⁵

Në të kundërt, kapitali i strukturuar i referohet investimeve të huaja që kontribuojnë pozitivisht në zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien shoqërore të vendit pritës. Këto investime i përmbahen praktikave etike të biznesit, respektojnë shtetin e së drejtës dhe promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm. Kapitali i strukturuar mund të çojë në përfitime të ndryshme, siç janë krijimi i vendeve të punës, transferimi i teknologjisë, shkëmbimi i njohurive dhe rritja e industrive lokale.⁹⁶

Tabela 4 – Kapitali gjërryes dhe i strukturuar

KAPITAL GËRRYES	KAPITAL I STRUKTURUAR
Flukse të paqarta të kapitalit të cilat nuk orientohen drejt tregut dhe kanë qëllim për të shfrytëzuar boshllëqet e qeverisjes për të ndikuar në zhvillimin ekonomik, politik dhe social në vendet përfituese.	Flukse investimesh të mirëqeverisura që shërbejnë për qëllime transparente, të orientuara nga tregu dhe të përgjegjshme si në burimet e financimit ashtu edhe në destinacionet.

Burimi: Qendra për Ndërmarrjet Private Ndërkombëtare, 2023

Gjatë shqyrtimit të investimeve të huaja, është e rëndësishme të merren parasysh treguesit që bëjnë dallimin mes kapitalit gjërryes dhe atij të strukturuar. Për të identifikuar kapitalin gjërryes, mund të vijnë në ndihmë disa tregues. Së pari, mungesa e transparencës dhe llogaridhënies karakterizon kapitalin gjërryes, pasi shpesh ai vepron në mënyra të errëta dhe jo transparente, duke penguar kontrollin dhe mbikëqyrjen efektive. Për më tepër, termat që lidhen me kapitalin gjërryes mund të sjellin ndikime negative në komunitetet lokale të biznesit, të tilla si konkurrenca e padrejtë, praktikatat monopoliste ose çmimet grabitqare, të cilat mund të minojnë qëndrueshmërinë e ndërmarrjeve lokale.

Për më tepër, dhënia e kontratave pa tender publik apo tender konkurrues është një tjetër tregues i kapitalit gjërryes. Kjo praktikë jo vetëm që minon konkurrencën e drejtë dhe të hapur të tregut, por gjithashtu rrit potencialin për korrupsion dhe favorizim. Për më tepër, kontratat që nuk i përmbahen standardeve mjedisore lokale dhe që rezultojnë me dëme ekologjike nënkuptojnë kapital gjërryes, pasi ato i japin përparësi fitimeve afatshkurtra në vend të zhvillimit të qëndrueshëm dhe administrimit mjedisor. Përfshirja e aktorëve me histori korrupsioni në këto kontrata përforcon më tej natyrën e errët të këtij kapitali.

Në të kundërt, treguesit e kapitalit të strukturuar ose konstruktiv përfshijnë kushtet transparente dhe hyrjen në treg. Investimet e kapitalit të strukturuar funksionojnë në një mënyrë që lejon shqyrtimin dhe vlerësimin nga palët përkatëse të interesit, duke nxitur llogaridhënien dhe zvogëluar potencialin për praktika shfrytëzuese. Kapitali i strukturuar është gjithashtu përgjegjës për një gamë të gjerë aktorësh lokalë në vendin pritës, duke përfshirë qeverinë, komunitetet lokale dhe shoqërinë civile, duke siguruar që investimi të përputhet me interesat dhe nevojat e vendit pritës. Për më tepër, kapitali i strukturuar justifikon investimet e tij bazuar në parimet e tregut, duke dëshmuar angazhim ndaj konkurrencës së ndershme, efikasitet dhe qëndrueshmëri afatgjatë.

⁹⁵ "Kapitali gjërryes: të panjohurat e njohura", Adam Goldstein dhe Eric Hontz, CIPE, 2021.

⁹⁶ Shiko ref. 70

Tabela 5 – Treguesit e kapitalit gërryes dhe të strukturuar

Treguesit e kapitalit gërryes	Treguesit e kapitalit të strukturuar
<ul style="list-style-type: none"> ● Mungesa e transparencës dhe llogaridhënies ● Kontratat jepen pa tender publik apo tender konkurrues ● Kushte që sjellin ndikime negative në komunitetet lokale të biznesit ● Kontratat nuk plotësojnë standardet mjedisore lokale dhe shkaktojnë dëme ekologjike ● Kontratat përfshijnë aktorët e angazhuar më parë në korrupsion ● Projektet kontribuojnë në prapambetjen demokratike me kalimin e kohës 	<ul style="list-style-type: none"> ● Kushte transparente dhe hyrja në treg ● Jep llogari një game të gjerë të palëve lokale të interesit në vendin marrës ● Justifikimi bazohet në parimet e tregut

Burimi: Qendra për Ndërmarrjet Private Ndërkombëtare

4.5. Mekanizmat e shqyrtimit dhe detyrimet e Shqipërisë në bazë të traktateve ndërkombëtare

Siç u theksua më sipër në këtë dokument, ka një prirje globale për vënien në zbatim të MSHI-ve. Duhet të theksohet se Shqipëria aktualisht nuk ka asnjë MSHI apo propozim për miratimin e një mekanizmi të tillë. Megjithatë, duke pasur parasysh detyrimin e Shqipërisë për të harmonizuar legjislacionin kombëtar me atë të BE-së, duhet t'i kushtohet një vëmendje e veçantë konflikteve të mundshme që mund të ndodhin mes zbatimit të MSHI-ve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare për investimet (MNI) ekzistuese.

MNI-të, zakonisht në formën e traktateve dypalëshe për investime ose të traktateve shumëpalëshe për investime, janë traktate ligjërish të detyrueshme që synojnë të promovojnë dhe mbrojnë investimet e huaja duke krijuar një kuadër rregullator e standardesh për trajtimin e investimeve të huaja në vendin pritës.

Shtyllat kryesore të këtyre mbrojtjeve përfshijnë, pa u kufizuar në, dispozita si mosdiskriminimi që përfshin si trajtimin kombëtar (TK) ashtu edhe trajtimin e vendit më të favorizuar (TVF), trajtimi i drejtë e i barabartë (TDB) dhe kompensimi i drejtë, i shpejtë dhe i përshtatshëm në rast shpronësimi. Shtetet kanë detyrime sipas TDI-ve dhe investitorët mund të kërkojnë grupin e lartpërmendur të mbrojtjeve, në rast veprimi ose mosveprimi nga ana e shtetit.

Shqipëria ka lidhur 45 TDI, nga të cilat 41 janë në fuqi. 23 nga 45 TDI janë lidhur me shtetet anëtare të BE-së.⁹⁷ Duke marrë parasysh kohën kur Shqipëria u bë palë e shumicës së TDI-ve, pjesa më e madhe e tyre duket se janë të “stilit të vjetër” dhe kryesisht nuk pasqyrojnë zhvillimet e fundit në të drejtën ndërkombëtare të investimeve.⁹⁸ Këto TDI përmbajnë dispozitat më të zakonshme të mbrojtjes, si mosdiskriminimi, trajtimi i drejtë e i barabartë dhe shpronësimi.

⁹⁷ Ministria e Zhvillimit, Ekonomisë, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, “Kapitulli 30: Marrëdhëniet me jashtë, traktatet dypalëshe për investime të Shqipërisë, copëzimi dhe analiza”, dhjetor 2016.

⁹⁸Ibid.

Ndërveprimi mes mekanizmave të shqyrtimit IHD-ve dhe dispozitave të mbrojtjes së TDI-ve mund të jetë kompleks, pasi qëllimet e dukshme të këtyre instrumenteve ligjore mund t'i sjellin ato në kundërshtim me njëra-tjetrën. Ndërsa mekanizmat e shqyrtimit të IHD-ve nga njëra anë janë mjete rregullatore që përdoren nga vendet pritëse për të vlerësuar dhe kufizuar potencialisht IHD-të për arsye të sigurisë kombëtare ose interesit publik, TDI-të nga ana tjetër synojnë të nxisin dhe promovojë investimet e huaja.

Siç është trajtuar më sipër, mekanizmi i shqyrtimit mund të kryhet si para-themelimi ashtu edhe pas krijimit të IHD-ve. Në vlerësimin e përplasjes së mundshme mes mekanizmave të shqyrtimit IHD-ve dhe dispozitave të TDI-ve, duhet të bëhet një dallim mes fazave para themelimit dhe pas themelimit.

Shumica e dispozitave të TDI-ve, veçanërisht ato "të modelit të vjetër", siç janë ato që lidhen kryesisht nga Shqipëria, zakonisht i referohen investimeve të bëra tashmë dhe jo domosdoshmërisht mbulojnë fazën e para themelimit. Për shembull, dispozitat e trajtimit kombëtar dhe të vendit më të favorizuar në traktatin dypalësh të investimeve mes Shqipërisë dhe Greqisë janë si më poshtë: "*Asnjë palë kontraktuese nuk do t'u japë **investimet** në territorin e saj, në pronësi ose të kontrolluara nga investitorët e palës tjetër kontraktuese, një trajtim më pak të favorshëm nga ai që u jep investimeve të investitorëve të vet ose investimeve të një shteti të tretë*".⁹⁹

Në mënyrë të ngjashme, TDI-ja Shqipëri-Kore e Jugut parashikon se "*Secila palë kontraktuese do të lejojë në territorin e saj **investime** dhe kthimin e investitorëve të palës tjetër kontraktuese një trajtim që është i drejtë dhe e barabartë dhe jo më pak i favorshëm se ai që u jep investimeve dhe kthimeve të investitorëve të vet ose investimeve dhe kthimeve të investitorëve të një shteti të tretë, cilido që është më i favorshëm për investitorët*"¹⁰⁰.

Gjithashtu përcakton se investim është "*çdo lloj pasurie e **investuar** nga investitorët e një palë kontraktuese në territorin e palës tjetër kontraktuese...*"¹⁰¹

Në të vërtetë, pjesa më e madhe e TDI-ve që ka lidhur Shqipëria përmbajnë një dispozitë të përgjithshme që parashikon se promovimi dhe mbrojtja e investimeve të huaja të kryera nga shteti pritës nuk përjashton respektimin e legjislacionit të brendshëm të shtetit pritës gjatë pranimit të IHD-ve, duke nënkuptuar mundësinë e krijimit dhe aplikimit të një mekanizmi shqyrtimi vendas. Për shembull, Traktati Shqipëri-Kinë parashikon se "*Secili shtet kontraktues do të inkurajojë investitorët e shteteve të tjera kontraktuese që të bëjnë investime në territorin e tij dhe **do t'i pranojë këto investime në përputhje me ligjet dhe rregulloret e tij***"¹⁰²

Nga formulimi i TDI-ve rezulton se aplikimi i mekanizmit të shqyrtimit në fazën e para themelimit me shumë mundësi nuk do të ishte në sferën e zbatimit të TDI-ve, megjithëse duhet t'i kushtohet vëmendje e duhur formulimit të çdo TDI-je të veçantë para se të dilet në përfundime. Nga ana tjetër, situata është krejt e ndryshme kur bëhet fjalë për fazën pas themelimit.¹⁰³

⁹⁹Neni 3, pika 1 e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Greqisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve, nënshkruar më 01.08.1991 dhe hyrë në fuqi më 04.01.1995.

¹⁰⁰Neni 3, pika 1 e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Koresë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve, nënshkruar më 15.12.2003 dhe hyrë në fuqi më 18.05.2006.

¹⁰¹Neni 1, pika 1 e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Koresë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve, nënshkruar më 15.12.2003 dhe hyrë në fuqi më 18.05.2006.

¹⁰²Neni 2, pika 1 e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore të Kinës dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve, nënshkruar më 13.02.1993 dhe hyrë në fuqi më 01.09.1995.

¹⁰³Ömer Büreyde Erdal, "Mekanizmi i shqyrtimit të investimeve dhe ndërveprimi i tij me detyrimet e traktatit të investimeve", Universiteti i Uppsalës, 2022.

Aplikimi i mekanizmave të shqyrtimit pas kryerjes së një investimi ka shumë të ngjarë të bëhet shkas që investitori i huaj të evokojë zbatimin e dispozitave të mbrojtjes nga TDI-ja.

I ashtuquajhuri aplikim retroaktiv i mekanizmave të shqyrtimit mund të ndikojë në detyrimet e ndërmarra në përputhje me TDI-të në disa mënyra:

i) Dispozita e trajtimit kombëtar dhe vendit më të favorizuar

Dispozita e trajtimit kombëtar kërkon që vendet pritëse të trajtojnë investitorët e huaj dhe investimet e tyre jo më pak të favorshme se investitorët vendas dhe investimet e tyre. Nëse një vend pritës zbaton një mekanizëm shqyrtimi që diskriminon investitorët e huaj, ai mund të shkelë detyrimin kombëtar të trajtimit sipas një MNI-je.

Dispozita e trajtimit të vendit më të favorizuar kërkon që vendet pritëse të ofrojnë trajtimin më të mirë për çdo vend të tretë, për investitorët e palëve të tjera të MNI-së. Nëse një vend pritës përjashton investitorë të caktuar nga kërkesat e shqyrtimit, por nuk shtrin të njëjtin trajtim për investitorët nga palët e MNI-së, ai mund të kundërshtohet sipas dispozitës së trajtimit të vendit më të favorizuar.

ii) Standardi i trajtimit të drejtë e të barabartë (TDB)

Shumë MNI- përfshijnë një standard TDB, i cili i detyron vendet pritëse t'u ofrojnë investitorëve të huaj një trajtim të drejtë e të barabartë. Nëse një mekanizëm i shqyrtimit të investimeve të huaja zbatohet në mënyrë arbitrare ose diskriminuese, mund të konsiderohet si shkelje e këtij standardi.

iii) Dispozita e shpronësimit

MNI-të zakonisht përfshijnë dispozitën e shpronësimit, duke kërkuar që vendet pritëse të kompensojnë investitorët e huaj për shpronësimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të investimeve të tyre. Nëse një mekanizëm për shqyrtimin e investimeve të huaja rezulton në shpronësimin *de facto*, kjo mund të çojë në shkelje dispozitës së shpronësimit.

iv) Mekanizmi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes investitorit dhe shtetit (MZMISH)

Shumë MNI parashikojnë mekanizmat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes investitorit dhe shtetit (MZMISH), duke lejuar investitorët e huaj të paraqesin pretendime kundër vendeve pritëse për shkelje të pretenduara të dispozitave të traktatit. Nëse një investitor i huaj beson se një mekanizëm shqyrtimi ka ndikuar negativisht në investimin e tij dhe shkel MNI-në, ai mund të nisë një arbitrazh MZMISH kundër vendit pritës.

Në përgjithësi, TDI-të parashikojnë dispozita për përjashtimin nga detyrimet e TDI-ve, të cilat mund të marrin një nga format e mëposhtme:¹⁰⁴

- a) Përjashtim shprehimisht nga shqyrtimi;
- b) Listat e masave që nuk janë të pajtueshme;
- c) Përjashtimi i sektorëve të veçantë që mund t'i nënshtrohen shqyrtimit;
- d) Përjashtimet për shkak të sigurisë;
- e) Përjashtimet e përgjithshme.

¹⁰⁴ Tania Voon & Dean Merriman, "Si ligji ndërkombëtar për investimet kufizon shqyrtimin e investimeve të huaja", *Gazeta e investimeve dhe tregtisë botërore* 24 (2023) 75-114.

Nëse Shqipëria vendos të zbatojë procedurat e shqyrtimit edhe në fazën pas themelimit, është i nevojshëm një vlerësim i plotë i TDI-ve aktuale në fuqi për të shqyrtuar çdo bazë të mundshme për përjashtim ose, në mënyrë alternative, për të përcaktuar nevojën për të vazhduar me ndryshimet e përshtatura për të shmangur çdo shkelje të mundshme.

V. PËRFUNDIME

Numri i vendeve që vendosin regjime të reja shqyrtimi dhe/ose ndryshojnë rregulloret ekzistuese është në rritje. Kjo është kryesisht për shkak të faktorëve gjeoekonomikë dhe për shkak të zhvendosjes së legjislacionit të investimeve nga barrierat e ulëta në çështjet e sigurisë kombëtare që lidhen me IHD-të. Përveç kësaj, ka një ndërgjegjësim në rritje të vendeve për pritjen e investimeve të rëndësishme jo vetëm për sa i përket numrit, por edhe për sa i përket cilësisë. Kjo e fundit shpesh perceptohet si e lidhur më shumë me vendin e origjinës së investitorit dhe sektorin e operimit.

Rregullorja e BE-së 2019/452 siguron një kuadër gjithëpërfshirës, në nivel BE-je, për shqyrtimin e IHD-ve për arsyen e sigurisë ose rendit publik. Dispozitat e rregullores dhe mekanizmat e shqyrtimit të investimeve të miratuara në disa juridiksione të BE-së janë një mundësi për përmirësimin e legjislacionit për IHD-të edhe në Shqipëri, të cilës i mungon aktualisht një mekanizëm zyrtar shqyrtimi.

Meqenëse objektivi afatgjatë i Shqipërisë është anëtarësimi në BE, kuadri i saj ligjor dhe rregullator duhet të jetë në përputhje me standardet dhe kërkesat e BE-së. Megjithatë nuk është ende një Shtet Anëtar i BE-së, Shqipëria ka detyrimin të përafrojë legjislacionin e saj të brendshëm me *acquis-in* e BE-së. Mbi këtë bazë, çdo zhvillim i ardhshëm ligjor për një ligj të ri për investimet (ligji i unifikuar të investimet) duhet të marrë parasysh gjithashtu dispozitat e Rregullores 2019/452 për mekanizmin e shqyrtimit, rekomandimet e KE-së, praktikat më të mira dhe mësimet e nxjerra nga shtetet anëtare nga ky legjislacion në zhvillim. Qëllimi duhet të jetë miratimi i një mekanizmi që krijon kontroll dhe ekuilibër mes nevojës së mirëfilltë për të mbrojtur sigurinë kombëtare dhe mundësisë së krijimit të një mjeti që rrit fuqinë e degës ekzekutive nga njëra anë, por që kufizon në të njëjtën kohë vendimet arbitrare. Për këtë qëllim, jurisprudenca në zhvillim e GJED-së¹⁰⁵ mund të shërbejë për të përcaktuar *standardet e larta ligjore mbi bazën e të cilave të bllokohen investimet e huaja*.

Për të vazhduar me këtë hap, kërkohet një grup veprimesh për t'u përgatitur për ndërhyrje efektive. Ato përfshijnë rritjen e ndërgjegjësimit për mekanizmat e shqyrtimit mes palëve të interesit në vend, vlerësimin në mënyrë efektive të rreziqeve të mundshme që vijnë nga IHD-të, kryerjen e një analize të thellë të ndikimeve nga vendosja e mekanizmave të tillë në legjislacionin e brendshëm, kryerjen e një analize të thellë të kapaciteteve administrative për të qeverisur këtë legjislacion specifik, identifikimin e praktikave më të mira, dhe së fundmi riorganizimin e zbatimit të saj në përputhje me piketat e përcaktuara qartë. Shqipëria mund të synojë të marrë ndihmën dhe bashkëpunimin e KE-së në bazë të nenit 13 “Bashkëpunimi ndërkombëtar” të rregullores. Sipas këtij neni “Shtetet Anëtare dhe Komisioni mund të bashkëpunojnë me autoritetet përgjegjëse të vendeve të treta për çështje që lidhen me shqyrtimin e investimeve të huaja direkte për arsye të sigurisë dhe rendit publik.”

¹⁰⁵ Më 13 korrik 2023, Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian konstatoi se vendimi i qeverisë hungareze për të bllokuar blerjen e planifikuar të një karriere hungareze të rërës dhe zhavorrit, sipas ligjeve të saj kombëtare për shqyrtimin e investimeve të huaja, ishte i papajtueshëm me rregullat e Traktatit të BE-së dhe në veçanti në shkelje të lirisë së themelimit.

Megjithatë, përfshirja e një mekanizmi shqyrtimi nuk duhet të minojë parimet e legjislacionit të IHD-ve: trajtimin e barabartë dhe mosdiskriminimin mes investitorëve të huaj (jo nga BE-ja), si dhe ofrimin e masave efektive të mbrojtjes, si në nivelin administrativ ashtu edhe në atë gjyqësor.

Politika aktuale kombëtare e investimeve bazohet në parimin e mosdiskriminimit mes investitorëve të huaj dhe atyre vendas. Në përgjithësi pranohet që drejtim të legjislacionit, Shqipëria konsiderohet si një vend miqësor për investime për arsytet e mëposhtme: (i) nuk kërkohet autorizim paraprak; (ii) nuk është i mbyllur asnjë sektor ndaj investimeve të huaja; (iii) nuk ka kufizime për sa i takon përqindjes së pjesëmarrjes së huaj tek shoqëritë; (iv) riatdhesim i lirë i kapitalit dhe fitimeve; (v) sistemi tatimor i Shqipërisë nuk bën dallime mes investitorëve të huaj dhe atyre vendas; (vi) investimet e huaja nuk mund të shpronësohen ose shtetëzohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë (përveçse për qëllime publike të përcaktuara me ligj); (vii) investimet dhe investitorët e huaj dhe vendas marrin trajtim të barabartë; si dhe (viii) investitorët e huaj në Shqipëri gëzojnë të drejtën e mbrojtjes gjyqësore të të drejtave ligjore që lidhen me investimet e tyre.

Së fundmi, IHD-të janë jetike për ekonominë shqiptare. Andaj, lundrimi në legjislacionin për IHD-të dhe shartimin e tyre, si nga këndvështrimi i qeverisë ashtu edhe i investitorëve të huaj të drejtpërdrejtë, duhet të jetë një ushtrim që siguron marzhe të mira të sigurisë juridike dhe parashikueshmërisë për investitorët e huaj pa paragjykim. Për të arritur këtë qëllim, çdo ndërhyrje në legjislacionin e IHD-ve kërkon modele të qëndrueshme dhe elastike, të cilat tashmë parashikohen në juridiksione të tjera me një traditë të gjatë në tërheqjen dhe mbajtjen e investitorëve të huaj. Andaj është me rëndësi që këto modele tilla të përshtaten me tiparet e IHD-ve në Shqipëri dhe që rreziqet e mundshme të investimeve të brendshme të vlerësohen paraprakisht.

VI. REKOMANDIME

6.1. Zgjidhje të zgjuara për MSHI-të

► ***Vendosja e bazave për diskutim profesional dhe transparent rreth mekanizmave të shqyrtimit të investimeve në nivel kombëtar.***

Si hap i parë, është e domosdoshme rritja e ndërgjegjësimit dhe gjenerimi i interesit mes palëve të interesit për mekanizmat e shqyrtimit të investimeve. Për ta arritur këtë, është e nevojshme që dispozitat e Rregullores së BE-së 2019/452 të paraqiten dhe të kuptohet ndikimi i tyre në legjislacionin e brendshëm aktual dhe të ardhshëm për IHD-të. Miratimi i mekanizmave të tillë, të cilët janë ende të rinj në shumë juridiksione, duhet të paraprihet nga prezantimi i qëllimeve të Rregullores së BE-së së bashku me përfitimet që rrjedhin nga përafrimi i legjislacionit vendas me *acquis-in* e BE-së dhe efektet e mundshme negative nëse nuk transpozohet siç duhet. Prandaj, aktorët kryesorë, siç janë bizneset, dhomat e tregtisë dhe shoqatat e biznesit, platformat e dialogut të politikave privat-publik, politikëbërësit, avokatët dhe ekspertët e IHD-ve, organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e ekspertëve, agjencitë qeveritare, institucionet publike dhe të pavarura me funksione ndërsektoriale në lidhje me IHD-të, si dhe mediat dhe academia, duhet të jetë të gatshëm përmes aktiviteteve të hershme dhe proaktive të angazhimit dhe të njihen me konceptin.

► ***Kryerja e një analize të thellë të faktorëve të mundshëm gjeo-ekonomikë dhe tendencave të IHD-ve që mund të shkaktojnë çështje të “sigurisë kombëtare” dhe “rendit publik” në kontekstin e Shqipërisë.***

Kjo është e domosdoshme për të identifikuar përfitimet dhe rreziqet e IHD-ve të brendshme në sigurinë ekonomike sipas sektorëve ekonomikë, nënsektorëve dhe pasurive, për të përshtatur më vonë MSHI-të për të zbutur sfidat përkatëse duke shmangur pasojat e padëshiruara, siç janë pengesat e gjera ndaj konkurrencës së ligjshme dhe trajtimi i padrejtë i investitorëve.

► ***Kryerja e një analize të thellë e kuadrit ligjor dhe rregullator aktual për IHD-të, duke përfshirë çështjet e qeverisjes, kapaciteteve institucionale dhe koordinimit.***

Analiza mund të rezultojë në zhvillimin e një propozimi për një koncept kombëtar të shqyrtimit të IHD-ve, duke identifikuar boshllëqet dhe mangësitë aktuale dhe nevojën për ndryshime ligjore dhe administrative që lejojnë përfshirjen më të mirë të shqyrtimit të investimeve në kuadrin ligjor dhe institucional kombëtar.

► ***Identifikimi i praktikave më të mira të mekanizmave të shqyrtimit të investimeve në nivel BE-je, duke u mbështetur në përvojën dhe mësimet e marra.***

KE-ja ofron informacion, raporte, analiza dhe ekspertizë të plotë në nivel teknik për dimensione të ndryshme dhe çështje praktike me të cilat shtetet anëtare janë përballur ose janë ende duke u përballur gjatë zbatimit të mekanizmave të shqyrtimit të investimeve. Shqipëria duhet të përfitojë nga përvoja e tyre e akumuluar dhe ekspertiza teknike, duke hartuar një mekanizëm efikas shqyrtimi që korrespondon me madhësinë e ekonomisë së saj dhe burimet e saj të kufizuara administrative.

► ***Qeveria të vlerësojë implikimet e Rregullores së BE-së 2019/452 për legjislacionin e brendshëm dhe t'i japë përparësi ndërhyrjeve në përputhje me objektivat e procesit të negociatave të anëtarësimit duke parashikuar pranimin e shpejtë dhe të plotë të acquis-it të BE-së.***

Në këtë drejtim, është e rëndësishme të miratohet një udhërrëfyes veprimesh dhe të riorganizohen pikësynimet në mënyrë që:

- publiku, në përgjithësi, dhe komuniteti i biznesit, në veçanti, të jenë të informuar për ndërhyrjet e politikave, qëllimet e tyre dhe ndikimin e pritshëm;
- të përfitohet nga një procesi cilësor i konsultimit paraprak të politikës së propozuar përmes Këshillit të Investimeve, Këshillit Ekonomik Kombëtar dhe platformave të tjera përkatëse të konsultimit publik, etj.;;
- të parashikohen pikat kyç të konfrontimit mes palëve të interesit dhe të propozohen mjete juridike specifike për zbatimin e politikave dhe praktikave;
- të përgatitet terreni për rregullime ligjore, institucionale, procedurale dhe administrative, si premisa të forta për ndërhyrje të qëndrueshme;
- të përfitohet nga asistenca praktike dhe teknike e BE-së, NATO-s, OECD-së, etj., gjatë punës për hartimin e legjislacionit gjithëpërfshirës dhe transparent për shqyrtimin e investimeve;
- të prezantohet mekanizmi i shqyrtimit si pjesë e ligjit të ri për investimet (ligji i unifikuar), i cili për vite me radhë pritet të përmirësojë qeverisjen e kuadrit ligjor për IHD-të;


- të rritet ndërgjegjësimi i komunitetit të biznesit për kërcënimet kritike, duke i lejuar ata të rregullat e brendshme.

► ***Shoqatat e Biznesit dhe Dhomat e Tregtisë do të fuqizohen në rolin e tyre për të ndikuar në mënyrë efektive për hartimin e politikave dhe nxitjen e debatit rreth IHD-ve dhe legjislacionin e shqyrtimit të investimeve. Në veçanti, ato duhet të jenë të afta:***


- të kuptojnë dhe të njohin kërcënimet dhe përfitimet e IHD-ve për ekonominë vendase dhe të ketë një pamje të qartë të dobësive;
- të angazhohen herët dhe në mënyrë proaktiv me politikëbërësit për të lehtësuar urën e informacionit për anëtarët e tyre;
- të angazhohen në dialog me homologët e tyre në të gjithë BE-në dhe ekonomitë e tjera të mëdha.

6.2. Drejt një legjislacioni të unifikuar dhe bashkëkohor për IHD-të

Si mundet të përmirësohet klima ekonomike e Shqipërisë nga një ligj i unifikuar për investimet?



Procedura bashkëkohore: Një ligj i unifikuar do të harmonizonte dhe thjeshtonte procedurat e investimeve duke eliminuar kërkesat e tepërta dhe duke zvogëluar barrën administrative, duke tërhequr kështu më shumë investitorë.



Qartësi dhe transparencë: Një ligj i unifikuar do të sillte qartësi dhe transparencë në kuadrin ligjor që rregullon investimet. Ai mund të përcaktojë procedurat, kërkesat dhe detyrimet e investimeve, duke zvogëluar kështu paqartësitë dhe duke promovuar barazinë mes investitorëve. Për më tepër, rregulloret e qarta mund të ndihmojnë në parandalimin e korrupsionit dhe nxitjen e qeverisjes së mirë.



Mbrojtja e investitorëve: Një ligj i unifikuar mund të sigurojë mbrojtjen e të drejtave të investitorëve dhe të sigurojë mekanizma ligjorë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Ai mund të përcaktojë rregulla të qarta për të drejtat e pronësisë, zbatimin e kontratave, mbrojtjen e pronësisë intelektuale dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes investitorëve dhe shteteve, duke krijuar një mjedis të sigurt dhe të parashikueshëm për investime.



Stimuj dhe përfitime: Një ligj i unifikuar mund të ofrojë stimuj dhe përfitimet e qeverisë për investimet me qëllim tërheqjen e investitorëve vendas dhe të huaj. Këto stimuj mund të përbëhen nga përjashtim nga taksat, grante, subvencione ose trajtime preferenciale për industri ose rajone të veçanta. Këto dispozita mund të nxisin investimet dhe të nxisin zgjerimin ekonomik.






Konkurrueshmëria ndërkombëtare: Një ligj i unifikuar në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira mund të rrisë konkurrencën e destinacioneve të investimeve të Shqipërisë. Ai mund të dëshmojë angazhimin e vendit për një mjedis të favorshëm biznesi, të inkurajojë sipërmarrësit vendas të investojnë në ekonominë e tyre dhe të tërheqin IHD-të.

Hartimi dhe zbatimi i një ligji të unifikuar për investimet është një proces kompleks që kërkon konsideratë të kujdesshme të faktorëve të shumtë, si sistemi ligjor, kushtet ekonomike, mjedisin politik dhe konsultimet me palët e interesit. Përfshirja e aktorëve kryesorë, siç janë investitorët, shoqatat e biznesit, ekspertët ligjorë dhe subjektet qeveritare, është thelbësore për hartimin e ligjeve që trajtojnë në mënyrën e duhur kërkesat dhe shqetësimet e të gjitha palëve.

SHTOJCA 1

Mekanizmat e shqyrtimit të IHD-ve në disa juridiksione

	 Bashkimi Evropian	 SHBA	 Kina
	Kuadri për shqyrtimin e investimeve të huaja direkte në Union ¹	Komiteti për Investimet e Huaja në Shtetet e Bashkuara (CFIUS) dhe që nga viti 2018, Ligji për Modernizimin e Rishikimit të Rrezikut të Huaj (FIRRMA) ²	Ligji për Investimet e Huaja ³
Të përdoret në bazë të një kërcënimi të mundshëm për sigurinë kombëtare	● ● ●	● ● ●	● ● ●
Ekipi përkatës harton në mënyrë proaktive fluksin hyrës të investimeve pa pritur njoftimin nga ndërmarrjet/shtetet anëtare	● ● ●	● ● ●	● ● ●
Njoftimi i detyrueshëm i IHD-ve hyrëse që mund të përbëjë një kërcënim për sigurinë kombëtare	● ● ●	● ● ●	● ● ●
Mundësisht për të zbatuar rregulloren për transaksionet e investimeve tashmë të përfunduara	● ● ●**	● ● ●	● ● ●
Fuqia për të bllokuar investimet	● ● ●***	● ● ●	● ● ●
Sistemi i sanksioneve në rast të njoftimit të humbur (nëse është i detyrueshëm)	● ● ●****	● ● ●	● ● ●
Agjenci e pavarur <i>ad-hoc</i> e ngarkuar me shqyrtimin dhe vlerësimin e transaksioneve (të njoftuara).	● ● ●	● ● ●	● ● ●

Burimi: [MERICS, 2021](#)

*Në rastin e SHBA-së dhe Kinës, kompanitë duhet t'i njoftojnë këto IHD hyrëse tek CFIUS dhe një Zyrë Pune e udhëhequr nga Ministria e Tregtisë (MOFCOM) dhe Komisioni Kombëtar i Zhvillimit dhe Reformës së Kinës (NDRC) përkatësisht. Në BE, shtetet anëtare njoftojnë Komisionin.

**Jo nëse ka ndodhur përpara datës 10 Prill 2019.

***E mundshme në nivel kombëtar

****Përgjegjësia e shteteve anëtare të BE-së

Burimet: ¹ Parlamenti Evropian dhe Këshilli i BE-së: <https://eur-lex.europa.eu/eli/reg/2019/452/oj>;

² Thesari i SHBA: <https://www.treasury.gov/resource-center/international/Documents/Summary-of-FIRRMA.pdf>;

³ SAMR: http://www.samr.gov.cn/djzcyj/zcfg/fl/202003/20200312_312860.html

SHTOJCA 2


Modeli gjerman

Gjermania ndryshoi rregullat e saj për shqyrtimin e investimeve të huaja direkte duke zgjeruar sektorët e mbuluar dhe duke ulur pragjet e aksioneve të nevojshme për të aktivizuar mekanizmin e shqyrtimit.¹⁰⁶

Ministria Federale për Çështjet Ekonomike dhe Veprimin Klimatik mund të rishikojë blerjen e firmave gjermane nga blerësit e huaj, rast pas rasti. Ligji për tregtinë me jashtë dhe pagesat dhe Urdhri për tregtitë me jashtë dhe pagesat përbëjnë bazën ligjore.

Gjermania ka miratuar një mekanizëm shqyrtimi ndërsektorial dhe specifik për sektorin. Pragjet e shqyrtimit janë të ulëta, deri në 10% e drejtave të votës, në varësi të sektorit, siç janë sektorët e infrastrukturës kritike ose të mbrojtjes. Për më tepër, ndërmarrjet mediatike janë shtuar në listën e sektorëve ku mund të shqyrtohet edhe një pjesëmarrje me 10% e të drejtave të votës.

Procedura e shqyrtimit të investimeve



Burimi: Ministria Federale për Çështjet Ekonomike dhe Veprimin Klimatik

¹⁰⁶ M. Kontak, "Vlerësimi i mekanizmit të shqyrtimit të BE-së dhe çështja e reciprocitetit me Kinën" (2021) 17 CYELP 203. <https://www.cyelp.com/index.php/cyelp/article/view/451>. Parë për herë të fundit më 29.05.2023.

Shqyrtimi ndërsektorial

Në parim, çdo blerje e një shoqërie nga investitorë me seli jashtë territorit të BE-së ose rajonit të EFTA-s, kur investitorët blejnë të paktën 25% të të drejtave të votës së një shoqërie rezidente në Gjermani, mund t'i nënshtrohen një shqyrtimi të tillë. Nëse blerësi i drejtpërdrejtë është rezident në territorin e BE-së, një rishikim i tillë mund të kryhet nëse ka indikacione për një qasje abuzive ose një transaksion mashtrues.

Shqyrtimi analizon nëse blerja përkatëse përbën një kërcënim për rendin ose sigurinë publike të Republikës Federale të Gjermanisë, p.sh. nëse blerja paraqet një kërcënim mjaft serioz dhe aktual që prek një interes themelor të shoqërisë. Prandaj, teksti i ligjit i referohet drejtpërdrejt legjislacionit të BE-së dhe jurisprudencës së GJED-së. Deri më sot, GJED-ja ka pranuar se rendi ose siguria publike mund të ndikohet nga blerjet që lidhen me çështje të tilla si siguria e furnizimit në rast krize, telekomunikacioni dhe energjia elektrike, ose ofrimi i shërbimeve me rëndësi strategjike.

Shqyrtimi sektorial

Në rastet e blerjeve të shoqërive që operojnë në fusha të ndjeshme të sigurisë, zbatohen rregulla të veçanta për rishikimin e investimeve. Këtu përfshihen prodhuesit dhe zhvilluesit e armëve të luftës dhe teknologjive të tjera kryesore ushtarake, veçanërisht motorët dhe kutitë e marsheve të projektuara për automjetet e blinduara të gjurmueshme ushtarake dhe produktet me karakteristika të sigurisë së TI-së që përdoren për përpunimin e informacionit të klasifikuar qeveritar. Çdo blerje e një shoqërie nga investitorë të huaj me anë të së cilës fitohet të paktën 10% e të drejtave të votës së një shoqërie rezidente në Gjermani mund t'i nënshtrohet një rishikimi të tillë.

BIBLIOGRAFIA

- Adam Goldstein dhe Eric Hontz “Kapitali gjërryes: të panjohurat e njohura”, CIPE, 2021.
- Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, “Broshura Investo në Shqipëri 2022”, 2022.
- Blackwill, RD, & Harris, JM (2016). “Lufta me mjete të tjera: Gjeo-ekonomia dhe arti i të bërit shtet”, Harvard University Press.
- CIPE, “Një kuadër për kapitalin e strukturuar: investimi, integriteti dhe ndikimi”, prill 2022.
- Dokumenti i Punës i Stafit të Komisionit për Investimet e Huaja Direkte në BE: Në vijim të Komunikimit të Komisionit “Mirëpritja e investimeve të huaja direkte duke mbrojtur interesat thelbësore”, të datës 13 shtator 2017, Bruksel, 13.3.2019 SWD (2019) 108 përfundimtar.
- Udhëzimet e KE-së 2020.
- Shërbimi i Kërkimit i Parlamentar Evropian, Kuadri i BE-së për shqyrtimin e IHD-ve, Bruksel, Parlamenti Evropian, prill 2019.
- Komisioni Evropian - Njoftim për shtyp, 10 prill 2019.
- Pyetjet më të shpeshta për Rregulloren (BE) 2019/452 që përcakton një kuadër për shqyrtimin e investimeve të huaja direkte në BE, 21 qershor 2021.
- J. Hillebrand Pohl “Rreziqet gjeo-ekonomike që lidhen me investimet e huaja”; punim i paraqitur në simpoziumin e institutit CELIS 2021.
- Jean-Claude Juncker (2017). Trajtimi i gjendjes së Bashkimit 2017. Fjalim Bruksel: Komisioni Evropian, 13 shtator 2017.
- OECD, Masat e sigurisë kombëtare (shënim nga Sekretariati), 21 nëntor 1995, DAF/MAI (95) 7.
- Legifrance, Dekret nr. 2019-1590 i 31 dhjetorit 2019 në lidhje me investimet e huaja në Francë, 01 janar 2020.
- M. Kontak, “Vlerësimi i mekanizmit të shqyrtimit të BE-së dhe çështja e reciprocitetit me Kinën” (2021) 17 CYELP 203.
- OECD (2021), “Zhvillimet e politikës së investimeve nga 16 tetori 2020 deri në 15 tetori 2021”, nëntor 2021.
- OECD, “Treguesit e cilësive të IHD-ve, matja e ndikimeve të zhvillimit të qëndrueshëm të investimeve”, 2021.
- OECD (2022), Kuadri për shqyrtimin e investimeve të huaja direkte në BE.
- OECD “Treguesit e cilësive të IHD-ve: 2022”, 2022.
- OECD “Treguesit e cilësive të IHD-ve – çështjet më të rëndësishme”, 2022.
- OECD (2023), Kodi i OECD-së për liberalizimin e lëvizjes së kapitalit.
- Rregullorja (BE) 2019/452 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 19 mars 2019 që përcakton një kuadër për shqyrtimin e investimeve të huaja direkte në BE [2019] OJ L79I/1 (Rregullorja për shqyrtimin e IHD-ve në BE.
- Sarah Bauerle Danzman, Qendra për Ndërmarrjet Private Ndërkombëtare (CIPE) 2023, “Formimi i politikës së sigurisë së investimeve: një udhëzues për shoqatat e biznesit”.

Steffen Hindelang dhe Jens Hillebrand Pohl, Raport mbi Forumin e CELIS për shqyrtimin e investimeve, ligji evropian për shoqëritë, vëllimi 20, botimi 1 (2023).

UNCTAD, “Monitorimi i politikës së investimeve: Mekanizmat e shqyrtimit mbi bazën e sigurisë kombëtare për investimet e huaja”, dhjetor 2019.

UNCTAD, “Monitorimi i politikës së investimeve: evolucioni i mekanizmave të shqyrtimit të IHD-ve”, shkurt 2023.

Zenobia T. Chan dhe Sophie Meunier, “Prapa skenës: si të kuptojmë mbështetjen kombëtare për një mekanizëm për shqyrtimin e investimeve të huaja në Bashkimin Evropian”, *Rishikimi i organizatave ndërkombëtare*, 13 korrik 2021.

Perspektiva ekonomike, Sekretariati i Këshillit të Investimeve të Shqipërisë, “Një vështrim mbi treguesit e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë (2022)”, prill 2023.

Ligje, strategji dhe dokumente të tjera

Ligji nr. 7764, datë 2.11.1993 “Për investimet e huaja” i ndryshuar.

Ligj nr. 96, datë 23.07.2020 “Për Kodin Ajror të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 8337, datë 30.04.1998 “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjeve, livadheve dhe kullotave”.

Ligj nr. 7980, datë 27.07.1995 “Për shitblerjen e trojeve”.

Ligj nr. 64/2012 “Për peshkimin”, i ndryshuar.

Ligj nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, i ndryshuar.

Dokumenti i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI 2015-2020, faqe 33).

Ligj nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar.

Programi politik i Qeverisë Shqiptare 2017-2021, faqe 5

https://kryeministria.al/wp-content/uploads/2021/10/Programi_Qeverises_2021-2025.pdf

Ligji nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar.

Lidhjet

https://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php

https://rdatirana.al/?page_id=23

<https://www.aida.gov.al/sq/>

<https://www.celis.institute>

<https://doi.org/10.54648/eucl2023002>

<https://link.springer.com/article/10.1007/s11558-021-09436-y#citeas>

<https://www.bmwk.de/Redaktion/EN/Artikel/Foreign-Trade/investment-screening.html>

<https://www.oecd.org/investment/investment-policy/investment-policy-national-security.htm>

<https://home.treasury.gov/policy-issues/international/the-committee-on-foreign-investment-in-the-united-states-cfius/cfius-laws-and-guidance>

<https://home.treasury.gov/policy-issues/international/the-committee-on-foreign-investment-in-the-united-states-cfius>

<https://investmentscreening.princeton.edu/data-visualizations/types-investment-screening-measures>

<https://merics.org/en/comment/screening-foreign-investment-eu-first-year>

<https://www.reuters.com/article/kuka-ma-midea-group-germany-idCNL5N18G482>

www.oecd.org/investment/codes.htm

https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/SPEECH_17_3165

<https://eur-lex.europa.eu/eli/reg/2019/452/oj>

<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32021R2126>

https://policy.trade.ec.europa.eu/enforcement-and-protection/investment-screening_en

[https://ec.europa.eu/transparency/documents-register/detail?ref=COM\(2022\)433&lang=en](https://ec.europa.eu/transparency/documents-register/detail?ref=COM(2022)433&lang=en)

<https://www.legifrance.gouv.fr/affichTexte.do?cidTexte=JORFTEXT000039727443&categorieLien=id>

[https://ec.europa.eu/transparency/documents-register/detail?ref=COM\(2022\)433&lang=en](https://ec.europa.eu/transparency/documents-register/detail?ref=COM(2022)433&lang=en)

<https://www.cliffordchance.com/insights/resources/blogs/antitrust-IHD-insights/2022/09/recent-amendments-to-the-italian-golden-power-regime-the-pre-notification-procedure.html>

<https://apnews.com/article/germany-china-hamburg-port-investment-cosco-0036bf44045321f3a2a35b1c941ef6a9>

<https://www.monitor.al/investimet-e-huaja-direkte-arriten-rekord-te-ri-ne-tremujorin-e-pare-te-vitit/>

<https://www.aida.gov.al/sq/biznes-ne-shqiperi/investime-te-huaja-direkte>

<https://euronews.al/en/85-of-strategic-investors-are-albanians/>

<https://corrosiveconstructivecapital.cipe.org>

<https://www.state.gov/investment-affairs/bilateral-investment-treaties-and-related-agreements/united-states-bilateral-investment-treaties/>

<https://investmentpolicy.unctad.org/international-investment-agreements/countries/2/albania>

<https://www.tatime.gov.al/c/6/125/marveshje-nderkombetare.%C2%A0>

<https://home.treasury.gov/system/files/206/Executive%20Order%2014105%20August%209%2C%202023.pdf>

<https://home.treasury.gov/policy-issues/international/outbound-investment-program>

<https://www.faz.net/aktuell/wirtschaft/unternehmen/wirtschaftsministerium-stellt-aixtron-uebernahme-durch-chinesen-in-frage-14495317.html>

<https://www.reuters.com/article/us-aixtron-m-a-fujian-germany-idINKBN13R14R>

<https://obamawhitehouse.archives.gov/the-press-office/2016/12/02/presidential-order-regarding-proposed-acquisition-controlling-interest>

<https://exit.al/en/albania-joins-us-the-clean-network-pledges-not-to-use-huawei-5g/>

<https://2017-2021.state.gov/the-clean-network/#:~:text=5G%20Clean%20Countries%20and%20Clean,to%20develop%20its%205G%20infrastructure>



www.icc-albania.org.al
c/o BKT, Rruga "Abdyl Frashëri"
përballë Vesa Center
Tirana, Albania



www.cipe.org
1211 Connecticut Avenue NW
Suite 700 | Washington
DC 20036